



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1165/7 Prot.

Tiranë, më 18 .12. 2024

V E N D I M

Nr. 306 , Datë 18.12. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.165 Regj., datë 13.08.2024, paraqitur nga znj. Dh.S , kundër Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) dhe znj.E.B , Inspektore e Përgjithshme, ILDKPKI, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron ndër të tjera se:

Unë Dh.S , punoj pranë ILDKPKI, në funksionin si inspektore, prej datës 03.05.2004. Gjatë marrëdhënies së punësimit në këtë institucion, jam përballur me veprime dhe mosveprime të kundërligjshme, në cenim të interesave të ligjshme të shtetit dhe të miat si shtetase, kryer nga Inspektorja e Përgjithshme, znj.E.B , si dhe punonjës të tjerë të këtij institucioni, si më poshtë:

Në lidhje me cenimin e interesave të mia si shtetase, duke qenë inspektore pranë ILDKPKI, që nga momenti i kandidimit tim për pozicionin e Inspektorit të Përgjithshëm pranë ILDKPKI, në dhjetor 2020, shtetasja E.B me zgjedhjen dhe marrjen e detyrës të Inspektorit të Përgjithshëm ka filluar dhe vijon të cenojë të drejtat e mia, të cilat lidhen me vendin e punës, funksionin zyrtar si inspektore e

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

ILDKPKI, statusin ligjor të punësimit si dhe të drejta që gëzon çdo shtetas/i punësuar në vendin e punës, sipas legjislacionit vendas dhe atij komunitar.

Duke qenë në funksionin e Sekretares së Përgjithshme, me zgjedhjen e saj nga Kuvendi i Shqipërisë në dhjetor 2020, si Inspektore e Përgjithshme, ka ndërmarrë veprime duke refuzuar ekzekutimin e vendimit nr.2504, datë 27.06.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, filluar me ekzekutim vullnetar nga ILDKPKI, me këste prej muajit dhjetor 2018, sipas shkresave nr.3570 prot., datë 14.12.2018 dhe shkresës nr.3581 prot., datë 17.12.2018, miratuar nga ish-Inspektori i Përgjithshëm, duke mos ekzekutuar ndaj meje si kreditore shumë 466.00 lekë, në zbatim të vendimit të gjykatës, mbajtur në kundërshtim me legjislacionin tatimor si pasojë e veprimeve të keqmenaxhimit të fondeve financiare, nga zyrtarët përgjegjës për financat e institucionit, të cilat në këtë rast duhet të përdorëshin pr detyrimet monetare që kishte institucioni ndaj punonjësve, lidhur me të drejtat e mohuara në elementë të veçantë të pagës, të fituara me vendim gjyqësor.

Menjëherë pas fillimit të punës si Inspektore e Përgjithshme, shtetasja E.B , në mënyrë të pakuptimtë dhe në formë presioni më ka dërguar *email* (në dijeninë time vetëm mua nga 28 inspektorë) me anën e të cilit më sqaronte rregullat më elementare të punës, pavarësisht eksperiencës prej 17 viteve punë si inspektore në ILDKPKI, me rekorde pozitive në kryerjen e funksionit zyrtar dhe detyrave të ngarkuara dhe vlerësuar ndër vite maksimalisht nga eprorët, sipas ligjit për statusin e nëpunësit civil.

Në mars 2021, kam qenë e sëmurë me Covid, kam njoftuar pranë ILDKPKI, duke paraqitur gjithashtu vërtetimin e mjekes së familjes, si dhe kam vënë në dijeni me *email* shtetasen E.B , për mungesën time në punë (ndërkohë që unë isha ende me lejen e vitit 2020, njoftuar Inspektorin e Përgjithshëm dhe paraqitur dokumentin (testimin serologjik), për kalimin e Covid gjatë kohës që isha duke kryer lejen vjetore të vitit 2020). Gjatë kësaj periudhe izolimi për shkak të Covid, kam ofruar shërbim duke punuar nga shtëpia dhe në mënyrë abuzive dhe diskriminuese, kjo shtetase nuk paguan të gjithë periudhën e izolimit nga Covid, por ka paguar pjesërisht periudhën që kam qenë me Covid, duke përgjysmuar pagën, duke prekur dhe kontributet për sigurime shoqërore.

Po kështu, për periudhën e trajtuar me “vërtetim”, lëshuar nga Qendra Shëndetësore në bazë të protokollit mjekësor për këto raste, kërkohet të paraqes raport mjekësor, duke mos njohur këtë dokument, i cili paguhet 100% nga punëdhënësi në raste me Covid, sikurse është vepruar për punonjës të tjerë në raste të tilla.

Më është mohuar kryerja e lejes vjetore e vitit 2020 (sqaroj, gjatë kohës që isha duke kryer lejen vjetore në gusht 2020 jam infektuar me Covid), si dhe leja vjetore e 2021 (sqaroj, jam caktuar si inspektore zëvendësuese pranë KJV, gjatë kohës që isha duke kryer lejen vjetore të vitit 2021, filluar më datë 23 gusht 2021, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare në datën 28 gusht 2021, në ILDKPKI, duke mu mohuar kryerja dhe pagesa për 22 ditë kalendarike për pushime vjetore)

Në gusht të vitit 2021, shtetasja E.B ka cenuar procesin e konkurimit për pozicionin e Gjyqtares pranë Gjykatës Kushtetuese, ndonëse isha kontrolluar si subjekt deklarues për shkak të të qenit inspektore e ILDKPKI dhe subjekt deklarimi prej 18 vite, ndonëse deklarimet dhe dokumentat

justifikues ishin të administruara nga institucioni, refuzoi të kryente kontrollin e pasurisë për efekt të këtij kandidimi, në zbatim të nenit 3/1 pika 2, e ligjit nr.9049/2003, i ndryshuar, duke sjellë mos kualifikimin tim në aspektin formal. Ndërkohë që me vërtetimin nr.3071 prot., datë 02.07.2021, të nënshkruar po prej shtetases E.B , si dhe vërtetimin nr.3171 prot datë 10.12.2020, prej ish Inspektorit të Përgjithshëm, pasqyrohet dhe vërtetohet se është kryer kontrolli i plotë i deklaratave të mia periodike, si subjekt deklarues, përcaktuar drejtpërdrejt në nenin 3, të ligjit nr.9049/2003, i ndryshuar.

Deklarimi prej meje si kandidate për anëtare në Gjykatën Kushtetuese, është paraqitur pranë ILDKPKI me postë brenda afatit ligjor dhe rezultoi se, pasi është bërë kontrolli paraprak është kthyer deklarata po me postë duke e konsideruar si të padorëzuar (gjithë dokumentacioni origjinal, refuzuar për tu marrë në dorëzim në datë 30 korrik 2021 nga protokollu i ILDKPKI dhe deklarimi dorëzuar në rrugë postare kryer prej meje, për efekt të kandidimit për anëtare të Gjykatës Kushtetuese, kthyer prej Inspektorit të Përgjithshëm, sikur të mos ishte dorëzuar prej meje pranë KED, në datë 5 gusht 2021 dhe nuk është tërhequr)

Shkaku për të cilin është kthyer deklarimi (ndonëse isha përjashtuar nga detyrimi për të dorëzuar deklarim të ri sipas nenit 3/1 pika 2 ligji 9049/2003, i ndryshuar) është mosdorëzimi së bashku me deklarin e paraqitur prej meje i dokumentave justifikues, sipas udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm, duke vendosur për herë të parë nga ky institucion një standard të hapur diskriminimi për një subjekt deklarues, në raport me kuadrin ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm në fushën e kontrollit dhe deklarin të interesave private, por dhe me të gjithë subjektet deklarues, përcaktuar në nenin 3, të ligjit 9049/3, i ndryshuar, për të cilët në amendimet e vitit 2006, të ligjit 9049/2003, i ndryshuar, ligji e ka hequr detyrimin ligjor që së bashku me deklarin dorëzohen edhe dokumentat justifikues (sqaroj se procesi i kontrollit nuk ishte proces vettingu për të cilin ka një kuadër tjetër ligjor specifik të zbatueshëm sipas rastit për subjektet e rivlerësimit kalimtar).

Nga ana tjetër, në këtë proces kontrolli jam diskriminuar në raport dhe me konkurrentët e tjerë për kandidat në Gjykatën Kushtetuese, sepse nuk janë zbatuar dispozitat e përcaktuara për përpunimin paraprak të deklaratës, sipas nenit 24, të ligjit 9049/2003, i ndryshuar, i cili parashikon plotësimet e gabuara të deklarin nga subjekti deklarues, sipas kësaj dispozite ligjore, dhe mandej gjatë fazave të kontrollit, në zbatim të nenit 27, duhet të thirret subjekti për të dhënë shpjegime, duke u diskriminuar nëpërmjet mohimit në mënyrë arbitrare të të gjithë të drejtave procedurale ligjore parashikuar nga legjislacioni specifik i fushës.

Me cilësinë e kandidates për anëtare në Gjykatën Kushtetuese (vënë në dijeni ILDKPKI me shkresën me nr.77, datë 29.07.2021 nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, shkresë e cila është administruar pranë këtij institucioni dhe KED) vazhdoja procedurat ligjore të ankimit kundër vendimeve të kryera nga Inspektore e Përgjithshme, në shkelje të ligjit, pranë KED dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, e cila u shoqërua nga Inspektorja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të ILDKPKI, me veprime haptazi të kundraligjshme dhe diskriminuese ndaj meje lidhur me marrëdhënien e punësimit si inspektore e ILDKPKI, si dhe statusin ligjor që gëzoja si zyrtare e nivelit të lartë drejtues, pranë një institucioni të pavarur. (sqaroj se, studimet e mia pasuniversitare janë kryer në fushën e deklarin

të pasurisë dhe konfliktit të të interesave dhe veprimet e kryera ndaj zyrtarëve të përfshirë nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve ndaj meje kanë dëmtuar drejtpërdrejt edhe veprimtarinë e Inspektoriatit, duke larguar nga zyrtarë profesionistë të fushës, me lloj lloj veprimesh në shkelje të ligjit, për një periudhë prej tre vjetësh nga institucioni)

Kështu, në gusht 2021 (në dijeninë time shtetasja E.B ka qenë jashtë shtetit) kanë dalë akte të nënshkruara prej saj, për transferimin tim në KJV, pa dijeninë time, pa u respektuar procedura ligjore e njoftimit sipas ligjit. Unë isha caktuar si Inspektore/anëtare zëvendësuese, për vakancat e përkohshme, sipas një shkresë të nxjerrë në vitin 2018 nga ish Inspektori i Përgjithshëm, por që në dijeninë time kjo shkresë është zëvendësuar me një shkresë tjetër në vitin 2019, kur filloi procesi i vettingut në polici. Ndërkohë që në rastet e mëparshme të vakancave, janë kryer zëvendësime, gjithmonë me pëlqimin e inspektorëve. Pra, transferimi im është bërë në mungesë të vakancës qoftë të përhershme apo të përkohshme, pasi Inspektorja, anëtare e KJV, është rikhyer në institucion, pas dorëheqjes nga KJV-ja. Për më tepër, pavarësisht se kam qenë në punë, kur është nxjerrë akti për caktimin tim si inspektore zëvendësuese pranë KJV, kam marrë njoftim, mbi kërkesën e bërë nga unë, pasi janë ndërprerë marrëdhëniet financiare, vetëm në 1 tetor 2021 (caktimi si inspektore zëvendësuese ishte kryer më datë 16 gusht 2021)

Edhe pse shtetasja E.B ka kryer këto veprime të njëanshme dhe ka qenë në dijeni që gjatë kësaj kohe kam qenë me raport mjekësor (nga data 07.09.2021 deri më datë 19.11.2021), ka vendosur gjobë në vlerën 200 000 lekë pa më njoftuar nëpërmjet autoritetit përgjegjës të ILDKPKI, që konsideronte transferimin pranë KJV, si përfundim/largim nga funksioni deklarues periodik/vjetor (veprime të cilat me vendimin nr.2142, datë 20.07.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, u konsideruan të paligjshme, pasi unë vazhdoja të isha subjekt edhe pas caktimit nga Inspektori i Përgjithshëm, në detyrën si anëtare e KJV)

Në vijim të veprimeve të kundërligjshme, është dërguar me postë dosja ime personale e punësimit, e cila administrohet konform ligjit prej 2004, nga punëdhënësi që është ILDKPKI, për shkak të marrëdhënies punësimit në funksionin e inspektores pranë ILDKPKI, duke gëzuar statusin e nëpunësit civil, dosje e cila është kthyer prej meje sërish në rrugë postare, drejt punëdhënësit ILDKPKI, me sqarimin se kryerja e veprimeve të tilla vinte në kundërshtim me ligjin.

Sqaroj se, një veprim i tillë diskriminimi, Inspektori i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë në këtë institucion, nuk e kanë kryer me asnjë prej inspektorëve të caktuar si anëtarë pranë KJV, pasi ligji 12/2018, përcakton në mënyrë të qartë se punëdhënësi, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, cakton për efekt të kryerjes së vettingut në polici 5 inspektorë të ILDKPKI për të qenë pjesë e trupës prej 15 anëtarësh për të kryer vettingun në polici. Me mbarimin e procesit të vettingut, anëtarët e KJV kthehen në vendet e punës. Duke patur parasysh që ndryshe nga 10 anëtarët e tjerë të KJV, Inspektorët e caktuar nga ILDKPKI caktoheshin nga Inspektori i ILDKPKI për shkak të funksionit të tyre dhe të qenit inspektorë në ILDKPKI, ishte përcaktuar nga ligji si kriter përzgjedhës, vetëm për punonjësit që caktoheshin nga Inspektori. Gjatë periudhës së zhvillimit të vettingut në polici, nga muaji shkurt 2019- 31 dhejtor 2022, të gjithë inspektorët e caktuar si anëtarë të KJV, janë kthyer pranë ILDKPKI, janë nxjerrë në pension pleqërie, pra ILDKPKI ka vazhduar të jetë punëdhënësi

edhe për pesë inspektorët e ILDKPKI, caktuar përkohësisht për shkak të ligjit, nga Inspektori i Përgjithshëm, si anëtarë të KJV.

Për shkak të veprimeve të kundërligjshme në nxjerrjen e akteve dhe vonesën e saj në komunikimin e tyre me Komisionin e Jashtëm të Vetingut, më është cenuar edhe e drejta e pagesës në kohë të raporteve mjekësore (kthimi i raporteve mjekësore të paraqitura gjatë kohës së isha me kryerjen e lejes vjetore të vitit 2021, dërguar në datë 7 shtator 2021, në padijeni të emërimit të kryer prej saj në datë 16 gusht 2021). Gjithashtu, për shkak të veprimeve të saj të paligjshme, më janë shkaktuar probleme me organet tatimore, pasi nuk ishin deklaruar saktë të dhënat pranë organeve fiskale pas caktimit tim pranë KJV dhe për këtë shkak është bllokuar llogaria e pagës pranë BKT në nëntor 2022, e cila zgjati rreth 15 ditë, duke mos qenë debitore ndaj shtetit.

Me përfundimin e veprimtarisë të KJV, shtetasja E.B është vënë në dijeni në dhjetor 2022 nga kryetarja e KJV, si dhe nga inspektorët e caktuar nga Inspektori i Përgjithshëm pranë këtij komisioni, midis tyre edhe unë, për mbarimin e veprimtarisë së KJV dhe kthimin në detyrë pranë ILDKPKI, në janar 2023, duke u paraqitur personalisht me datën 04.01.2023, dita e parë e punës për vitin 2023. Pas takimit dhe komunikimit me Drejtoreshën e Personelit dhe Sekretarin e Përgjithshëm të ILDKPKI, në hollin e institucionit, mu tha se do të njoftohesha nëpërmjet telefonit për tu paraqitur në punë, sa të bëheshin gati dhe të sistemoheshin zyrat, por shtetasja E.B dhe zyrtarë të tjerë, në kundërshtim me ligjin, në datë 26.01.2023, nëpërmjet shkresës nr.259/3 datë 26.01.2023, kanë nxjerrë aktin e paligjshëm për caktimin tim në listë pritje dhe nga data 1 janar 2023 deri më datë 13 qershor 2024, janë ndërprerë ndaj meje marrëdhëniet financiare dhe kontributet shëndetësore dhe shoqërore (sqaroj se vendimi nr.566, datë 13.03.2023 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur se edhe gjatë periudhës së kryerjes së detyrës së anëtarit të KJV kam patur statusin e nëpunësit civil, ndryshe nga sa ka vendosur Inspektoria e Përgjithshme për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil dhe jo të marrëdhënies financiare për periudhën e kryerjes së kësaj detyre, në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, veprime të cilat afektonin emërimin si anëtarë të KJV caktuar prej saj, pasi cenonin kriteret e zgjedhshmërisë si anëtar i KJV, përcaktuar në ligj për punonjësit e caktuar nga ILDKPKI)

Edhe pse nga DAP, në përgjigje të shkresës dërguar prej saj, është sqaruar se nuk jam në rrethin e nëpunësve civilë TND të cilët mund të nxirren në listë pritje, edhe pse nuk është bërë një proces përgjedhje nga Inspektoret që ishin anëtarë KJV, edhe pse ka patur vende të lira në organikën e ILDKPKI-së për inspektorë në janar 2023 kur jam kthyer pranë ILDKPKI me mbarimin e detyrës së caktuar prej saj (edhe pse vendi duhet të qëndronte i lirë për sa kohë zgjaste shkakun e transferimit) sërish në mënyrë arbitrare dhe diskriminuese në kundërshtim me ligjin shtetasja E.B, vetëm mua nga të gjithë inspektorët e caktuar anëtarë të KJV, më ka cenuar të drejtën e pagës dhe të drejtat e tjera që përfitoja si nëpunës civilë.

Për shkak të diskriminimit dhe hakmarrjes që prej datës 01.01.2023 – 13.06.2024 nuk kam përfituar shërbime shëndetësore në institucionet e shërbimit shëndetësor, për shkak të veprimeve të paligjshme me ndikim në marrëdhënien e punësimit, edhe pse kam rreth 30 vjet që paguaj kontributet e

sigurimeve shoqërore dhe shendetësore, duke mos kryer kontrollet e nevojshme ose duke kryer pagesa për këto kontrolle edhe pranë institucioneve shtetërore dhe private.

Është mjaft shqetësuese për mua dhe familjen time që për shkak të funksionit që kam kryer si inspektore prej vitit 2004 pranë ILDKPKI, në një periudhë kohe prej tre vjetësh, ndodhem në një situatë të tillë, duke qenë viktimë në vendin e punës nëpërmjet diskriminimit dhe hakmarrjes, kryer nga zyrtarë me funksione drejtuese në këtë institucion, por jo vetëm, nëpërmjet veprimeve denigruese kryer në një institucion dhe nga zyrtarë që kanë objekt të punës mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në vendin e punës, duke vazhduar hakmarrja dhe diskriminimi ndaj meje edhe pas kthimit tim në ILDKPKI, më 13 qershor 2024.

Sipas njoftimit dhe shkresave të dërguara nga vetë ILDKPKI (për arsye se ishte krijuar vend i lirë për shkak të daljes në pension pleqërie të inspektorit N.K, ish anëtar i KJV, i cili sipas ligjit pas mbarimit të detyrës si anëtar i KJV, ndryshe nga unë, u kthye në detyrën e inspektorit pranë ILDKPKI), pasi jam kthyer në punë, jam vendosur në kushte të papërshtatshme pune, pa u marrë parasysh problemet e mia shëndetësore, të cilat kanë filluar prej vitit 2017 (trajtuar me raporte mjekësore në vitin 2017, viti 2021 dhe aktualisht) për shkak të ngarkesës dhe volumit të madh të punës që kam përballuar si pasojë e reformave ligjore në të cilat u përfshi ILDKPKI (e megjithatë sqaroj se asnjëherë nuk jam paguar përgjatë kësaj periudhe, për shtesë mbi pagë sikurse janë paguar shumë zyrtarë të përfshirë edhe ish Sekretaren e Përgjithshme)

Pas njoftimit dhe kthimit tim në ILDKPKI, jo vetëm që nuk jam kthyer në postin e punës që kam patur para caktimit si anëtare e KJV, por nuk më është kthyer asnjë prej pajisjeve të punës në ngarkimin tim sipas inventarit që kam patur në ngrakim në gusht 2021, dita e fundit e punës para se të filloja lejen vjetore, inventar i cili është në ngrakimin tim dhe nuk është dorëzuar asnjëherë prej meje. (si kompjuter, printer, USB, materiale personale të cilat ndodheshin në tavolin e punës dhe në dollapin që përdorej prej meje, por dhe materjale të punuara prej meje të cilat ndodheshin të ruajtura në kompjuter dhe shërbejnë për vazhdimin e punës, përfshirë edhe materjale personale të punuara, tema, prezantime etj) për shkak të veprimeve arbitrare të kryera në gusht të vitit 2021, pavarësisht kërkimit të bërë prej meje pranë njesisë përgjegjëse dhe punonjësve të IT.

Po kështu, jam vendosur në një post pune që ndodhet në një ambjent të madh në katin e gjashtë të ndërtesës, i cili për shkak të konstruktit të ndërtesës duke qenë taraca e objektit dhe përshtatur më vonë si ambjent lokal dhe mandej është shfrytëzuar për nevoja pune, ka temperatura të larta në verë dhe të ulta në dimër, si dhe aksesimi i tualetit ndodhet një kat më poshtë, pa ashensor, kushte të cilat më kanë dëmtuar shëndetin tim, në këtë periudhë, por kanë cenuar edhe efincencen time në punë dhe përmbushjen e detyrave të caktuara brenda afatit ligjor. Ndonëse një shqetësim të tillë në mënyrë verbale ia bëra të ditur Sekretarit të Përgjithshëm, kam marrë një përgjigje se nuk kemi zyra dhe këto janë kushtet, pra është evidentuar një mungesë vullneti për të vepruar, duke më diskriminuar për shkak të marrëdhënieve që ka vendosur drejtuesja e institucionit në raport me mua si ish konkurenten e saj për drejtimin e këtij institucioni në dhjetor 2020.

Gjatë vitit akademik 2023-2024, jam angazhuar në procesin e mësimdhënies pranë Shkollës së Magjistraturës, në programin fillestar dhe në programin vazhdues, duke nënshkruar marrëveshjet me Shkollën e Magjistraturës. Për këtë periudhë kam qenë në listë pritje, nga punëdhënësi, pasi u refuzua me përfundimin e veprimtarisë së KJV, kthimi im në vendin e punës inspektore në ILDKPKI, sipas ligjit 12/2018, caktuar nga Inspektoria e Përgjithshme, si inspektore zëvendësuese pa pëlqimin tim dhe në mungesë të vakancës, pranë këtij komisioni, pasi anëtarja e KJV është kthyer pranë ILDKPKI dhe në asnjë rast tjetër nuk ka ndodhur refuzimi për të kthyer inspektorët/anëtarë të KJV, që caktoheshin pranë këtij organi kolegjal nga ILDKPKI.

Pasi jam kthyer në detyrën e inspektorit të ILDKPKI (pas njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i ILDKPKI nëpërmjet shkresës nr.259/3, datë 23.01.2023) kam vënë në dijeni Inspektorin e Përgjithshëm për përfshirjen time në procesin e mësimdhënies pranë Shkollës së Magjistraturës, duke kërkuar leje për datën 21 qershor 2021, datë e cila ishte caktuar sipas programit vazhdues të miratuar për vitin 2023-2024, për tu referuar nga unë (shkresa nr.2641 prot., datë 14.06.2024, drejtuar Inspektore së Përgjithshme, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm)

Në përgjigjen e kthyer nga Inspektore e Përgjithshme (shkresa nr.2641/1 prot., datë 20.06.2024) thuhej midis të tjerave “vendosni në dispozicion orarin e plotë (ditë/muaj/vit/orë) gjatë të cilit parashikohet të angazhoheni pranë Shkollës së Magjistraturës”. Në përgjigjen e datës 21 qershor 2024, drejtuar znj.B. , sqarova se, sikur kisha parashtruar në kërkesën për marrje leje pranë saj, data e vetme që kishte mbetur nga viti akademik 2023-2024, ishte vetëm data 21 qershor 2024, lidhur me trajtimin vazhdues që bëhej pranë kësaj shkolle, për angazhimin e mëtejshëm do të vendosja në dispozicion përsa kërkohej, pasi nuk kishte program mësimor të miratuar. Në këto kushte, në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm në datë 20 qershor, kontaktova me Drejtoreshën e Administrimit dhe Financës (znj.F.D (H.) dhe i komunikova verbalisht se të nesërmen nuk do të paraqitesha në punë, se isha pranë shkollës, kisha vënë në dijeni Inspektoren e Përgjithshme dhe Sekretarin e Përgjithshëm, dokumentacion i cili ndodhej i depozituar pranë zyrës së protokollit, për tu tërhequr prej saj.

Në datën 21 qershor, ora 12:06, gjatë kohës që isha duke referuar pranë Shkollës së Magjistraturës, në numrin tim privat të celularit më vjen një sms nga një numër telefoni (xxxxxxxxxx) ku më thuhet: “Përshëndetje znj.S. , nga verifikimet e listprezencës/hyrje-daljet e punonjësve, rezulton që në ditën e sotme nuk jeni paraqitur në punë. Kë keni njoftuar për mosprezencën tuaj? Drejtorja e Burimeve Njerëzore të ILDKPKI”

Pas përfundimit të trajnimit, u ktheva në punë rreth orës 13 e 30 dhe kërkoja disa herë të takoja Drejtoreshën e Personelit, por nuk ndodhej në zyrë. Pas orës 14.00 punonjësit e zyrës u larguan pasi kishin marrë njoftimin për tu larguar më herët nga puna për shkak të temperaturave të larta, në këto kushte vazhdova të punoja pas orarit zyrtar dhe pasi gjeta të mbyllur zyrën e Drejtoreshës së Personelit, kam nisur drejt numrit nga i cili më erdhi sms, të identifikoj se kush ishte, por nuk mora asnjë përgjigje.

Në datën 24 qershor 2024, ditën pasuese të punës, ditë e hënë, nuk u paraqita në punë për shkaqe shëndetësore dhe njoftova recepsionistin dhe Sekretarin e Përgjithshëm, për mungesën në punë. Nga qendra mjekësore, raporti mjekësor u përcoll në mënyrë *online*, pranë punëdhënësit, por pavarësisht kësaj nga po i njëjti numër celulari më vjen *sms* “Përshëndetje znj.S. , keni lajmëruar se sot nuk mund të paraqiteni në punë për arsye shëndetësore, ditën që do të ktheheni në punë të paraqisni dhe raportin për paaftësi në punë. Të shkuara! Drejtoria e Burimeve Njerëzore ILDKPKI”. Një mesazh i pakuptimtë, që në situatën që ndodhesha ishte mjet presioni dhe diskriminim i hapur ndaj meje, pasi sikurse sqarova raportet mjekësore dërgohen pranë punëdhënësit *online* dhe po në këtë mënyrë përcillen dhe aksesohen edhe nga pacienti/i punësuari. Veprime të tilla ishin në vazhdim të një sjellje diskriminuese ndaj meje, pasi kërkohej të paraqisja raport mjekësor për probleme Covid (në mars 2021). Po kështu në qershor 2024, kërkohet paraqitja e raportit mjekësor kur tashmë nëpërmjet sistemit elektronik ky veprim kryhet *online* pranë qendrave shëndetësore, drejt punëdhënësit dhe pacienit sikurse punëdhënësi, e akseson raportin në formë elektronike.

Pas përfundimit të raportit mjekësor, jam paraqitur tek Drejtoresha e Personelit, e cila pyetjes time se i kujt ishte numri i cili kishte nisur mesazhe drejt celularit tim, ju përgjigj se ishte numri i saj dhe mesazhet nga ai numër ishin nisur nga Sekretari i Përgjithshëm, po kështu më konfirmoi se raporti mjekësor ishte përcjellë *online* nga Qendra Shëndetësore.

Në këtë situatë kam kërkuar takim me Sekretarin e Përgjithshëm, i cili për shkak të funksionit ishte vënë në dijeni në mënyrë shkresore dhe verbale për procesin e mësimdhënies dhe për pamundësinë time shëndetësore, për të sqaruar situatën dhe për të kuptuar se çfarë po ndodhte ndaj meje, por prej tij u anashkaluan këto situata me një qëndrim indiferent dhe arrogant, si dhe refuzoi kërkesën time të përsëritur për të më sistemuar për shkak të të problemeve shëndetësore, në një nga zyrat e punës që ndodheshin në katet e tjera të godinës. Për problemet shëndetësore për shkak të ngarkesës nga procesi vettingut, që më filluan prej muajit janar 2017, Sekretari i Përgjithshëm kishte dijeni, pasi ishte një prej personave caktuar nga Inspektori i Përgjithshëm, për kontrollin e dosjeve të përfunduara që relatoheshin nga Inspektorët dhe Nd/Inspektorët.

Ajo çfarë ishte poshtëruese dhe diskriminuese, në sjelljen e këtij zyrtari, ishte fakti që jo vetëm mbajti një qëndrim indiferent për situatën shqetësuese që më kishin krijuar me pa të drejtë dhe për të cilën kisha kërkuar takim, por vazhdoi duke më sjellë fakte të ndodhura në gusht të vitit 2021, kryer nga zyrtarë të ILDKPKI, në dijeni edhe të tij, për shkak të konkurimit për anëtar në Gjykatën Kushtetuese (të cilat janë bërë prezent dhe parashtruar nga unë nëpër seanca gjyqësore, pranë Kuvendit të Shqipërisë si institucion epror, por edhe pranë ambasadave të cilat asistojnë reformat ligjore në të cilat është përfshirë edhe ILDKPKI) tashmë publike, sikur ishin thënë Drejtoreshës së Personelit, me të cilën nuk kam patur asnjë njohje, duke refuzuar të më ballafaqonte me këtë zyrtare, e cila rezultoi një prej zyrtareve përgjegjëse përfshirë në veprimet e kryera ndaj meje për gjithë këtë periudhë, në shkelje të ligjit.

Për më tej, veprimet diskriminuese kanë vazhduar duke dërguar pranë Shkollës së Magjistraturës shkresa nëpërmjet të cilës janë kryer verifikime lidhur me mësimdhënien pranë shkollës nga ana ime

dhe për të cilën kërkova leje pranë drejtuesve të ILDKPKI, si veprimtari e cila lejohet në bazë të ligjit.

Poshtërimi dhe diskriminimi në veprimet e kryera nga këta drejtues të ILDKPKI shkon në atë nivel sa mbasi më lanë një vit e gjysëm pa mjete jetese, pasi më kthyen në 13 qershor 2021, duke më vënë në kushte të vështira pune dhe duke mos marrë parasysh gjendjen time shëndetësore, kanë kryer verifikime nëpërmjet Operatorit të Kujdesit Shëndetësor, kërkuar nga zyrtarë drejtues të ILDKPKI, lidhur me raportin mjekësor pranë mjekes, e cila administron kartelën time shëndetësore.

Verifikimet kanë vazhduar nëpërmjet Operatorit të Kujdesit Shëndetësor (rajonal) edhe pasi kam dalë në Komision Mjekësor, për shkak të problemeve shëndetësore të shkaktuar nga veprime të papërgjegjshme dhe diskriminuese të zyrtarëve të cilët po vazhdojnë të përdorin funksionin shtetëror, në mënyrën më të paskrupullt, edhe pas kthimit tim në vendin e punës, jo vetëm kundër interesit publik, por duke shkaktuar dëme shëndetësore ndaj zyrtarëve të cilët kanë punuar me integritet të lartë në kryerjen e funksionit publik, gjatë gjithë periudhës së punësimit në këtë institucion të pavarur, për të ruajtur vlerat dhe standardet profesionale, integritetin e institucionit, në funksion të qëllimit të ligjit.

Konstatoj dhe është e evidente se, edhe pas datës 13 qershor 2024, vazhdon një situatë hakmarrëse dhe diskriminuese e cila kryehet për shkak të funksionit zyrtar që unë kam kryer në ILDKPKI, për shkak të qëndrimit tim shpeshherë kritik ndaj veprimeve dhe fenomeneve për të cilat kam menduar ndryshe nga drejtuesit e këtij institucioni, për shkak të gjendjes time arsimore dhe profesionale, profilizuar në fushën e veprimtarisë së këtij institucioni, për shkak edhe të gjendjes time shëndetësore, në të cilën ndodhem aktualisht, për shkak të ngarkesës së punës të përballuar prej meje dhe të papaguar njësoj sikurse zyrtarë të tjerë në këtë institucion, nga zyrtarët përgjegjës pranë ILDKPKI, por dhe zyrtarë të tjerë të cilët unë nuk jam në gjendje ti identifikoj se çfarë interesash kanë në kryerjen e veprimeve të tilla diskriminuese ndaj meje.

Ndaj meje vazhdon situata e rënduar e një presioni të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë, në formën më të keqe të sjelljes jo të shëndetshme, nën një presion të vazhdueshëm, nga të njëjtët zyrtarë për shkak të funksionit publik, nëpërmjet diskriminimit dhe hakmarrjes, duke më vështirësuar kryerjen e detyrave të mia funksionale, duke dëmtuar dhe prishur qetësinë time emocionale, por dhe të familjarëve të mi (sqaroj se bashkëshorti është operuar nga zemra në vitin 2014 dhe është i sëmurë kronik dhe trajtohet me KEMP), në kushtet e një përndjekje dhe kushte të papërshtatshme pune, duke marrë parasysh problemet e mia shëndetësore, të cilat janë shkaktuar si pasojë e ngarkesës së madhe në punë me fillimin e procesit të reformës në drejtësi dhe që ndryshe nga shumica e të punësuarve në këtë institucion, pavarësisht vlerësimeve maksimale për punën e kryer ndër vite nga Inspektori i Përgjithshëm, nuk jam paguar financiarisht sikurse janë paguar inspektorët dhe zyrtarët e tjerë.

Zyrtarë të ILDKPKI për shkak të hakmarrjeve personale të drejtuesit të institucionit për shkak të veprimeve në shkelje të ligjit kryer me dashje apo nga mosnjohja e ligjit prej tyre gjatë kryerjes së funksionit zyrtar, kanë kryer ndaj meje dhe vazhdojnë të kryejnë (edhe pas kthimit tim në datë 13 qershor 2024) në vendin e punës, veprime diskriminuese duke cenuar të drejtat dhe mbrojtjen nga

ligji, lidhur me marrëdhëniet e punësimit, duke kryer veprime verifikuese për një veprimtari të lejuar nga ligji, pranë institucionit publik mësimdhënës, Shkollës së Magjistraturës, veprime për mësimdhënien e ushtruar prej meje gjatë kohës që isha nxjerrë prej tyre në listë pritje, pa pagesë dhe për të cilën me tu kthyer pranë ILDKPKI, vura në dijeni drejtuesit e këtij institucioni, si dhe verifikime pranë Operatorit të Kujdesit Shëndetësor, për raportet mjekësore lidhur me gjendjen time shëndetësore, veprime të cilat haptazi janë në vazhden e veprimeve diskriminuese të nisura ndaj meje prej dhjetorit 2020, nga disa zyrtarë me funksione drejtuese në funksion të hakmarrjes që aktualisht kanë për qëllim krijimin e një ambienti pune konfliktual, jo të qetë, dhe për të ma vështirësuar jo vetëm përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve profesionale prej meje, por duke cenuar imazhin tim pranë institucioneve publike, nëpërmjet presionit dhe përcjelljes së armiqësisë personale që kanë me mua, drejtuesit e këtij institucioni, pranë institucioneve publike mësimdhënëse dhe institucionet e kujdesit shëndetsor.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe korrigjimin e situatës diskriminuese, duke e rikthyer ankuesen në të njëjtat kushte si ato përpara ndodhjes së diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/c, përcakton se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin*

e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”.

1. *Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr.165 datë 13.08.2024, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj. Në datën 20.8.2024, ankueses iu kërkuar nëpërmjet postës elektronike (me email) që të plotësonte ankesën me informacionin e nevojshëm. Në ankesën e saj ankuesja ndër të tjera shprehet: “...Konstatoj dhe është e evidente se edhe pas datës 13 qershor 2024, vazhdon nje situatë hakmarrese dhe diskriminuese e cila kryhet për shkak të qëndrim tim shpeshherë kritik ndaj veprimeve dhe fenomeneve për të cilat kam menduar ndryshe nga drejtuesit e këtij institucioni.....”*

Në këtë kontekst, ankueses iu kërkuar të sqaronte, se cilat ishin qëndrimet kritike që ajo kishte mbajtur ndaj veprimeve dhe fenomeneve të cilat i kishte menduar ndryshe nga drejtuesit e institucionit dhe si provohet që subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa kanë patur dijeni për qëndrimet dhe mendimet e saj të ndryshme dhe kritike.

1.1 Në datën 23.8.2024, ankuesja ktheu përgjigje nëpërmjet postës elektronike (me email), duke parashtruar ndër të tjera se:

“Sqaroj se qëndrimi tim ndryshe nga drejtuesit e institucionit, lidhet me veprime dhe fenomene lidhur me ushtrimin e funksionit publik të këtyre personave, në shkelle të legjislacionit (i) për nëpunësin civil; (ii) statusit ligjor ndaj zyrtareve të nivelit të lartë drejtues, që mbajnë funksione të posaçme, pranë institucioneve të pavarura të krijuara me ligj (inspektorët e ILDKPKI, inspektorët e ILDKPKI caktuar nga Inspektori i Përgjithshëm anëtarë të KJV); (iii) për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike; (iv) për parandalimin e konfliktit të interesave, në ushtrimin e funksioneve publike; (v) për procesin e rivlerësimit/vettingut në drejtësi dhe në policinë e shtetit; (vi) për administrimin dhe drejtimin e Institucioneve të Pavarura të krijuara me ligj (sipas vendimit të Kuvendit Shqipërisë Nr.134, datë 20.12.2018, Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik).

Në këtë këndvështrim, qëndrimi tim ndaj shkelleve të kryera është përcjellë fillimisht pranë drejtuesve të këtij institucioni më pas pranë Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë dhe insitucionit të Kuvendit të Shqipërisë si dhe pranë Gjykatave (sipas vendimeve gjyqësore, janë rregulluar pasojat e paligjshme që kanë sjellë veprimet/mosveprimet e drejtuesve dhe zyrtarëve të ILDKPKI). Subjektet kundër të cilëve është bërë kjo ankesë kanë patur dijeni për qëndrimet dhe mendimet e mia të ndryshme dhe kritike për veprimet/mosveprimet kryer prej tyre, nga unë drejtpërdrejt dhe nga Kuvendi i Shqipërisë pranë të cilit është depozituar kërkesë - ankesa ime që prej muajit prill 2022 e në vazhdim.”

2. Në datën 9.9.2024, ankuesja ka përcjellë me email komunikimin vijues:

“Në vijim të komunikimeve të mëparëshme, doja tju informoja për një situatë të rë për të cilën vetëm ditën e sotme jam vendosur në dijeni.

ILDKPKI ende nuk ka bërë pagimin e dy raporteve mjekësore për sëmundje që trajtohen nga komisioni mjekësor dhe mbulohen nga sigurimet shoqërore. Raporti i parë është lëshuar për periudhën 16.07.2024 deri në 15.08.2024, kurse raporti i dytë mbulon periudhën 15.08.2024 - 14.09.2024. Ndonëse raportet kanë kaluar pranë institucionit në mënyrë elektronike në momentin e lëshimit të tyre nga komisioni përkatës, ILDKPKI ende nuk ka derdhur pagën e 2 muajve të fundit në llogarinë time bankare.”

3. Në datën 9.9.2024, ankuesja ka përcjellë me *email* komunikimin vijues:

“Në vijimësi të komunikimit të mësipërm, po ju drejtohem për t'ju informuar për komunikimin që kam pasur me Drejtorinë e Burimeve Njerzore pranë ILDKPKI-së, lidhur me çështjen e mospagesës së dy raporteve mjekësore të dorëzuara gjatë muajve të fundit. Bashkëlidhur do të gjeni komunikimet, gjithashtu edhe shkresën nga Dega e Përfitimeve Afatshkurtra dhe Invaliditetit e cila më është gjeneruar në portalin e-Albania. Siç evidentohet nga komunikimet, Drejtoria e Burimeve Njerzore më njofton se për sqarime të mëtejshme duhet të adresohem pranë ISSH. Ndërkohë që në shkresën datë 23.08.2024, ISSH i drejtohet ILDKPKI-së duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe ridërgimin e praktikës me postë. Gjithashtu, në po të njejtën shkresë kuptoj që klasifikimi i pozicionit tim është identifikuar si “punonjës sezonal dhe i përkohshëm”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

4. Me shkresën nr.1165/1 prot., datë 29.08.2024, Komisioneri ka kërkuar informacion nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa. Në vijim, me shkresën nr.2851/1 prot., datë 12.09.2024, ka kthyer përgjigje znj. E.B , Inspektore e Përgjithshme e ILDKPKI, duke parashtruar sa vijon:

ILDKPKI, në vlerësimin në tërësi të parashtrimeve të paraqitura nga ankuesja znj.S. , me keqardhje konstaton se përpjekjet për të cenuar integritetin dhe veprimtarinë e institucionit kanë vijuar edhe pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Konkretisht në mënyrë të vazhdueshme, përgjatë katër viteve të fundit, janë paraqitur nga znj.S. , ankesa pranë institucioneve të tjera publike, si dhe janë paraqitur kërkesë padi pranë organeve gjyqësore, të cilat kanë rezultuar të pabazuara, si në prova, ashtu edhe në kuadrin ligjor në fuqi.

Kështu, sjellim në vëmendje ankesën e paraqitur nga znj.S. pranë Kuvendit të Shqipërisë, e cila përmban pjesën më të madhe të parashtrimeve që janë paraqitur edhe pranë Komisionerit dhe që kanë gjetur trajtim në shkresën nr.1880/1 prot., datë 03.05.2023 të Inspektoriatit të Lartë.

Siç është trajtuar në shkresë, theksojmë se, në lidhje me pretendimet e ankueses për kandidimin e saj për vendet vakante për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, procedura e kandidimit të znj.Dh.S , i është

nënshtruar një vendimarrje të plotë dhe të gjithanshme, në të gjitha institucionet përgjegjëse, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Konkretisht, pretendimet e parashtruara janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigje nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), ku në përfundim të procedurës administrative, KED ka marrë vendimin nr.4, datë 31.08.2021 *“Për ndalimin e kandidimit të zonjës Dh.S në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 16.01.2017, 19.04.2019 dhe 03.06.2021”*, si dhe vendimin nr.5, datë 31.08.2021 *“Për ndalimin e kandidimit të zonjës Dh.S në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, 19.04.2019 dhe 03.06.2021”*. Në përfundim të kësaj procedure administrative ankuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, në cilësinë e juridiksionit fillestar në çështjen me këtë objekt, duke paditur njëkohësisht KED dhe ILDKPKI.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të procedurës së ndjekur, Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin nr.65, datë 29.09.2021, duke vendosur përfundimisht rrëzimin e padisë së palës paditëse Dh.S , në lidhje me kërkimet ndaj KED, si dhe pushimin e padisë për kërkimet ndaj ILDKPKI. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala paditëse Dh.S , më datë 22.11.2021, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pranimin e padisë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim rekursin e rekursueses Dh.S , përfundimisht me vendimin nr.00-2022-684 (nr.31003-00064-2022 i Regjistrimit Themeltar), datë 17.03.2022, vendosi: *“Mospranimin e rekursit të palës paditëse Dh.S kundër vendimit nr.175/1 (31155-02738-86-2021), datë 07.12.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit”*

Në vijim, ankuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqzimin e vendimit nr.65, datë 29.09.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata Kushtetuese në përfundim të shqyrtimit të kërkesës në seancë plenare vendosi përfundimisht me vendimin nr.23, datë 10.10.2022 (shpallur më datë 9.11.2022), rrëzimin e kërkesës së kërkuueses Dh.S .

Për sa më sipër, procedura e kandidimit të ankueses Dh.S për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, ndonëse ajo pretendon se janë kryer paligjshëm ndaj saj, është shqyrtuar gjyqësisht dhe për të janë marrë vendime gjyqësore të formës së prerë, jo vetëm nga juridiksioni gjyqësor administrativ, por edhe nga Gjykata Kushtetuese, në kuadër të procesit të rregullt ligjor, duke rrëzuar në tërësi pretendimet e saj, të cilat janë të njëjta me sa parashtrohet në ankesën drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Për më tepër, në lidhje me pretendimet e ankueses për emërimin e saj pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJV), kjo procedurë është shqyrtuar gjyqësisht nga Gjykata Administrative e Apelit. Kjo Gjykatë, me vendimin nr.236, datë 3.2.2022, ka vendosur rrëzimin e padisë së palës paditëse Dh.S . Në kuadër të kësaj vendimarrje, të gjitha aktet administrative që lidhen me marrëdhënien e punës së ankueses pranë KJV janë akte administrative në fuqi, që prodhojnë efekte ligjore, të cilat

janë shqyrtuar edhe gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke rrëzuar pretendimet e palës ankuese.

Në këtë kuadër sqarojmë se, nuk ka pasur asnjë procedurë diskriminuese ndaj znj.S. , për aq sa, siç rezulton nga aktet bashkëlidhur, me shkresën nr.1957/1 prot., datë 30.4.2018, Inspektori i Përgjithshëm vendosi caktimin e inspektorëve të cilët do të ishin anëtarë të KJV. Në emrat e caktuar si anëtarë zëvendësues ishte znj.Dh.S. dhe znj.V.K. Për të dyja këto inspektore është ndjekur e njëjta procedurë për caktimin e tyre në vendet vakante të hapura pranë KJV, ku znj.K. nuk ka paraqitur asnjë ankesë, duke vijuar përmbushjen e kompetencave në zbatim të kuadrit ligjor, ndërsa znj.S. ka ndjekur rrugën gjyqësore të përfunduar me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Në lidhje me pretendimin për rikthimin në punë, pas përfundimit të veprimtarisë së KJV, sjellim në vëmendje të Komisionerit, se aktualisht është duke u zhvilluar procesi gjyqësor pranë gjykatës administrative të shkallës së parë, me palë paditëse Dh.S. dhe palë të paditur ILDKPKI, me objekt *“Kthim në detyrë...”* Në këtë kuadër, të gjitha kërkesat dhe dokumentacioni lidhur me këtë procedurë do të vendosen në dispozicion të gjykatës me vendimin e saj.

Megjithatë, sqarojmë se kjo procedurë është trajtuar në përputhje me parashikimet, jo vetëm të ligjit nr.152, datë 30.5.2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, por edhe të ligjit nr.12/2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.

Konkretisht, me vendimin nr.18, datë 30.8.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI *“Për pezullimin e marrëdhënieve në shërbimin civil, të znj. Dh.S , për shkak të ligjit për periudhën përkatëse të emërimit”*, si dhe urdhrin nr.8, datë 26.8.2021, të KJV *“Për fillimin e marrëdhënieve financiare për znj. Dh.S pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit”*, znj.Dh.S , është caktuar anëtare e KJV nga radhët e inspektorëve të ILDKPKI (trajtuar edhe vendimarrja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për këtë çështje).

Me shkresën nr.147 prot., datë 29.12.2022 të KJV me lëndë *“Njoftim për hyrjen në fuqi të Ligjit nr.78/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” , të ndryshuar”*, është njoftuar ILDKPKI për përfundimin e marrëdhënieve të punës, në datë 31.12.2022, të anëtarëve të KJV, të caktuar nga radhët e inspektorëve të ILDKPKI.

Me shkresën nr.259/3 prot., datë 26.01.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm të ILDKPKI me lëndë *“Kthim përgjigje”* i është bërë me dije znj.S. , se pozicioni i Inspektorit është plotësuar përfundimisht, e për rrjedhojë është vendosur në listë pritje në zbatim të ligjit nr.152/2013 datë 30.5.2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.

Për më tepër, znj.S. , me qëllim dhënien e mundësisë për të qenë përsëri pjesë e nivelit të lartë të shërbimit civil, i është vendosur në dispozicion lista e dërguar nga DAP për vendet vakante në administratën publike, për të shprehur pëlqimin e mundshëm për pozicionet e propozuara.

Praktika e ndjekur sa më sipër, vjen në përputhje me parashikimet e nenit 56 “Efektet e pezullimit” të ligjit nr.152, datë 30.5.2013, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori. Në rast se kjo është e pamundur, nëpunësit regjistrohen në një listë, e cila administrohet nga njësia përgjegjëse. Ata qëndrojnë në këtë listë deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

1/1. Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, t’ia ofrojë fillimisht këtyre nëpunësve civilë, që plotësojnë kriteret përkatëse, duke respektuar në çdo rast shkaqet e përmendura nga neni 48, pika 3, e këtij ligji, i cili në këtë rast zbatohet me ndryshimet përkatëse.

1/2. Këta nëpunës civilë mund të emërohen përkohësisht me pëlqimin e tyre edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Njësia përgjegjëse në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve.

2. Në rastin e pezullimit për një afat deri në 3 muaj, pozicioni i mëparshëm i punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit.....”

Kështu, ILDKPKI, ka trajtuar marrëdhënien e punës dhe statusin e nëpunësit civil për ankuesen, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, çka i bën pretendimet e saj të pambështetura në ligj. Konkretisht, me shkresën nr.3759 prot., datë 22.12.2022, Inspektoriat i Lartë i është drejtuar DAP, për të marrë në rrugë zyrtare vendet vakante në TND, me qëllim garantimin e sistemimit të znj.S. , në një pozicion të barazvlefshëm. Në praktikën bashkëlidhur, ndryshe nga sa parashtrohet në ankesë mbi praktikën e DAP, lehtësisht është e evidentueshme që znj.S. ka pasur mundësinë për të paraqitur kërkesë për një nga vendet e lira në TND dhe për të kryer procedurën me qëllim garantimin e pagesës së saj.

Për sa i përket çështjeve të parashtruara dhe që bien në fushën e veprimtarisë së KMD, mbi kushtet shëndetësore të znj.S. dhe trajtimi i saj ndryshe nga inspektorët e tjerë theksojmë:

Në vlerësim të shkaqeve të parashtruara, sjellim në vëmendje se është fyese dhe denigruese ndaj punës kolosale të kryer nga grupi i punës i ngritur për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përpjekja për të përvetësuar një punë që nuk është kryer prej saj. Kështu, siç rezulton nga të dhënat e administruara pranë Inspektoriatit të Lartë, znj.S. nuk ka qenë pjesë e urdhrin për ngritjen e grupit të punës për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe nuk rezulton asnjë dosje e përfunduar prej saj, për ndonjë subjekt në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në lidhje me ambjentet e punës, znj.S. është vendosur në të vetmin vend të lirë pune, të mbajtur më parë nga nëpunësi me funksion “Inspektor” vakanca e të cilit u plotësua me kthimin në punë të saj.

Zyra në të cilën është sistemuar znj.S. , ku theksojmë janë të vendosur dhe dy inspektorë të tjerë, ka të gjitha kushtet e domosdoshme të punës, ndriçim natyral, elektrik, ajrim dhe kondicionim, pajisjet dhe mjetet e punës. Zyra ndodhet në katin e gjashtë, në një godinë ku deri në katin e 5-të është në dispozicion ashensori, në gjendje pune 24/24, dhe vetëm një kat për tu ngjitur. Të gjitha katet janë të pajisura me ambiente lehtësuese për nevojat shëndetësore të nëpunësve.

Për sa më sipër, nëse do të pranohen pretendimet e znj.S. , atëherë do të ndodheshin në kushte diskriminimi ndaj inspektorëve edhe ndihmës inspektorët e tjerë, që ndodhen në të njëjtin ambient.

Nëse do të parashtrijmë çështjen e diskriminimit, i vetmi diskriminim që është bërë ndaj znj.S. , ka qenë një diskriminim pozitiv, pasi është vlerësuar për moshën dhe periudhën e gjatë të shkëputjes nga Inspektoriati i Lartë, i është ngarkuar një numër më i ulët subjektsh për të kryer kontrollin e plotë. Për më tepër, Ndhmës Inspektori, i ngarkuar për ta ndihmuar gjatë procesit të kontrollit të plotë është në të njëjtën zyrë me znj.S. .

Për sa i përket pretendimit për paraqitje kërkesë, siç rezulton nga të dhënat e administruara pranë Inspektoriatit të Lartë, znj.S. është rikthyer në punë me marrëdhënie financiare më datë 13.6.2024 dhe për periudhën qershor e deri aktualisht, është paraqitur në punë vetëm 8 ditë punë. Pjesa tjetër është trajtuar me raport mjekësor. Në këto ditë pune, nuk ka kërkesë të paraqitur prej saj mbi kushtet e punës, si rrjedhojë as korrespondencë të mbajtur.

Gjithashtu, theksojmë se në dosjen e personelit të znj.S. njësor si të gjithë nëpunësit e tjerë, përfshirë kategoria “Inspektor” mbi kushtet shëndetësore, është raporti mjekësor “I aftë për punë”, duke mos pasur ndonjë dokument mbi aftësitë ndryshe, me qëllim garantimin e të drejtave që kuadri ligjor njeh për këtë kategori.

Në lidhje me pretendimet për angazhim pranë Shkollës së Magjistraturës, procedura e ndjekur për trajtim të kërkesës për të kryer veprimtari të jashtme, është plotësisht në përputhje me parashikimet e VKM nr.874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”, dhe mbështetjen e kërkesave të nenit 10, në pikën 6 parashikohet se: “...Mbështetur në të dhënat e marra, eprori direkt, në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, verifikon nëse veprimtaria që do të kryejë nëpunësi, kategorizohet si e lejueshme sipas këtij vendimi. Eprori direkt merr vendim për përcaktimin e veprimtarisë së jashtme, si të lejueshme apo jo dhe i’a komunikon atë, me shkrim, nëpunësit kërkuar....”. Znj.S. , ndryshe nga sa parashtron, është angazhuar në veprimtari të jashtme ende pa përfunduar procedura e verifikimit nga eprori direkt.

Për sa më sipër, znj.S. nuk është trajtuar në asnjë rrethanë në mënyrë diskriminuese nga Inspektoriati i Lartë, i cili ka ushtruar dhe do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi, provuar me dokumentacionin bashkëlidhur.

5. Me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr. 1165/4 prot., datë 01.10.2024, ankuesja ka parqitur kundërshtimet e saj, duke parashtruar ndër të tjera:

Në kundërshtim me pretendimet e znj. B. , në ankesën time për këtë periudhë katër vjeçare janë trajtuar shkeljet ligjore që hyjnë në kompetencat e Komisionerit, të mbështetura nga dokumentacioni përkatës. Ndërkohë, diskriminimi ndaj meje në vendin e punës nga znj.B. dhe disa zyrtarë të ILDKPKI-së nuk ka qenë objekt shqyrtimi në organet gjyqësore dhe nuk ka asnjë vendim të formës së prerë që lidhet me shkaqet e këtij diskriminimi.

Konstatohet se në përgjigjen e kthyer nga znj. B. , vazhdon e njëjta qasje diskriminuese, në ushtrimin e funksionit publik jo për qëllimin e ligjit dhe në funksion të hetimit që po kryhet pranë Komisionerit, duke mos paraqitur dokumentacionin dhe procedurat e kërkuara dhe që ndodhen pranë ILDKPKI, duke kryer deklarime të pavërteta në cenim të figurës time si zyrtar publik dhe punës së kryer si inspektore në ILDKPKI, gjatë reformës në drejtësi.

Kundërshtoj sjelljen denigruese të znj.B. , në lidhje me ushtrimin e të drejtës ligjore si zyrtare publike, për t'u mbrojtur në vendin e punës nga veprimet diskriminuese të kryera prej saj, duke cenuar rëndë interesin publik dhe interesin tim personal, për hakmarrje personale, pranë institucionit epror, Kuvendi i Shqipërisë dhe organet e drejtësisë, duke i paraqitur si një *“përpyetje për të cenuar integritetin dhe veprimtarinë e institucionit”*.

Situatat diskriminuese në shkelje të ligjit ndaj meje duke qenë viktimë e veprimeve të saj, të cilat i kam referuar pranë institucioneve publike për mbrojtjen e interesit publik dhe interesit tim personal, nuk më bëjnë mua individin apo zyrtaren pa integritet, siç është përpyetur të paraqesë situatën diskriminuese ndaj meje gjatë këtyre katër viteve znj.B. në përgjigjen e saj, por janë veprime diskriminimi të cilat faktojnë riviktimizimin tim nga veprimet dhe sjelljes së saj.

Në kundërshtim me pretendimin për ankesën drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, nuk ekziston asnjë vendimarrje lidhur me ankesat e mia për veprimet hakmarrëse dhe diskriminuese ndaj meje. Përkundrazi pas kësaj ankese, veprimet diskriminuese kanë patur një ndikim të drejtëpërdrejtë në marrëdhënien time të punës si inspektore në ILDKPKI, duke më ndaluar të kthehem në vendin e punës më 31.12.2022, me përfundimin e detyrës si inspektore zëvendësuese pranë KJV.

Pas kthimit tim në punë më 13.06.2024, veprimet diskriminuese kanë vazhduar, duke ndikuar në mospagesën e raporteve mjekësore për periudhën 14.07.2024 deri më 14 tetor 2024, për shkak të deklarimeve të pasakta të ILDKPKI pranë organeve tatimore. Këto deklarime kanë rezultuar në mospagimin e detyrimeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore, suplementare, si dhe detyrimeve të tjera që burojnë nga marrëdhënia ime e punës e ndërprerë në mënyrë të paligjshme, gjatë periudhës së vendosjes sime në listën e pritjes.

Nuk është dhënë asnjë shpjegim për numrin e inspektorëve të caktuar nga ILDKPKI si anëtarë pranë KJV-së, në kuadër të procesit të vetingut të policisë. Gjithashtu, nuk janë dorëzuar kopjet e procedurës së ndjekur për caktimin e tyre si anëtarë të KJV, si dhe të procedurës së rikthimit të tyre në vendin e punës pranë ILDKPKI pas përfundimit të detyrave në KJV. Sipas shkresës nr.1957/1 prot., datë 30.04.2018, anëtarë të KJV-së kanë qenë inspektorët: 1. E.D, 2. M.B, 3. Z. Gj, 4. A. L, 5. B.H, dhe anëtarë zëvendësues: 1. Dh.S dhe 2.V.K. Me fillimin e punës së KJV në shkurt 2019,

anëtarë kanë qenë inspektorët: 1. E.D, 2. A.M, 3. Z.Gj, 4. A.L 5. B.H. Gjatë viteve kanë shërbyer si anëtarë zëvendësues: L.Q (2019), K.N (2019), N.K (2021), Dh.S (2021), V. K (2021). Të gjithë inspektorët janë rikthyer në vendet e tyre të punës përveç meje, duke më diskriminuar dhe duke më ndaluar të kthehem në vendin tim të punës pranë ILDKPKI më 04.01.2023, kur përfundoi veprimtaria e KJV.

Kam qenë subjekt diskriminimi, duke u riviktimizuar, pas kthimit në vendin e punës pranë ILDKPKI, më datë 04.01.2023 (dita e parë e punës për këtë vit) duke më ndaluar të kthehem në vendin e punës dhe duke cenuar marrëdhënien e punësimit, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare, pagesën e detyrimeve për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore për një periudhë 18 mujore, vetëm ndaj meje si inspektore, caktuar anëtare KJV, pa asnjë shkak ligjor.

Nuk është dërguar informacion i plotë dhe i saktë në lidhje me ambientet e punës ku jam sistemuar pas rikthimit në punë në qershor 2024, përfshirë vendodhjen e zyrës, kushtet e vendit të punës, nëse ka punonjës të tjerë të akomoduar në të njëjtin ambient me mua dhe nëse ata i përkasin të njëjtës kategori, pra nëse janë inspektorë të tjerë. Në lidhje me këtë pikë, nuk është përcjellë informacioni i kërkuar, duke anashkaluar çështjen e diskriminimit në raport me legjislacionin për krijimin e kushteve të përshtatshme të punës (si karrige pune, tavolinë pune, kompjuter etj) të cilat janë thelbësore për rritjen e efikasitetit në punë dhe për mbrojtjen e shëndetit të zyrtarit. Gjithashtu, sendet e mia personale që kisha lënë në vendin e punës më datë 20.08.2021 nuk më janë kthyer në asnjë moment, përfshirë dokumente që ndodheshin në kompjuterin e mëparshëm. Materialet e krijuara nga unë gjatë periudhës së pandemisë nuk janë të aksesueshme, pasi në momentin e rikthimit në ILDKPKI, më datë 13.06.2024, më është dhënë një kompjuter i boshatisur.

Gjithashtu prania e inspektorëve të tjerë nuk nënkupton se edhe ata kanë probleme shëndetësore që mund të krijojnë vështirësi në përmbylljen me efikasitet të detyrave të tyre funksionale në këtë mjedis pune. Konstatimi i znj. B. për “diskriminim pozitiv”, nuk ka relevancë bazuar në nenin 11, të LMD. Këto masa të marra ndaj meje nuk janë të përkohshme dhe të veçanta për përshtetimin e vendosjes reale të barazisë. Për më tepër, dy inspektorët e tjerë të ndodhur në të njëjtin ambient me mua, nuk ndodhen në të njëjtat kushte shëndetësore si unë. Shtojmë këtu faktin që 23 inspektorët e tjerë të atij institucioni janë vendosur në zyrat që aksesohen me ashensor. Deri në këtë pikë, nuk legjitimohet diskriminimi pozitiv i znj. B. .

Gjithashtu, duke ndjekur logjikën e znj.B. , duket se ndihmës-inspektorët e tjerë që nuk punojnë në një mjedis pune janë të diskriminuar, pasi nuk punojnë në të njëjtin ambient pune me inspektorët e caktuar për të kontrolluar dosjet, gjithashtu janë diskriminuar në raport me ndihmës inspektorin e caktuar për të punuar me mua, pasi ndodhet në të njëjtin ambient pune me inspektorin.

Po kështu, ndihmës inspektori në procesin e kontrollit, mbështetur në urdhrin e nxjerrë nga Inspektori i Përgjithshëm, ushtron kompetencat e përcaktuara sipas rregullores së brendshme të ILDKPKI dhe këto kompetenca nuk përbëjnë “diskriminim pozitiv” për zyrtarin i cili ushtron funksionin e inspektorit, sikurse përpiqet znj.B. të paraqesë kryerjen e detyrave në procesin e kontrollit që kryhet pranë ILDKPKI.

Nga ana tjetër, moshja dhe periudha e gjatë e shkëputjes nga Inspektoriati i Lartë vlerësohen si shkaqe të cilat sipas znj.B. , janë vlerësuar si shkaqe për të më ngarkuar një numër më të ulët subjektësh. Nuk është e vërtetë se mua më është ngarkuar një numër më i ulët subjektësh. Nëse znj.B. ka vlerësuar të veprojë në këtë mënyrë duhet të provojë para Komisionerit se ky pretendim është i vërtetë. Nga ana tjetër, duhet të provojë para Komisionerit se në këtë rast “*mosha ime dhe periudha e shkëputjes së gjatë nga Inspektoriati*”, janë shkaqe ligjore, për të diskriminuar inspektorët e tjerë që punojnë në këtë institucion. Për një gjë të tillë nuk ka patur asnjëherë kërkesë nga ana ime.

Nuk është ofruar informacion sipas dokumentacionit, në lidhje me ndërtesën ku ILDKPKI ushtron veprimtarinë e saj, përfshirë numrin e kateve dhe nëse ndërtesa është pajisur me ashensor që shërben për të gjitha katet (nëse ndërtesa ka më shumë se një kat). Për këtë çështje, pranë ILDKPKI gjendet dokumentacioni për strukturën e godinës, i lëshuar nga subjekti ndërtues, pas miratimit të fondeve për ndërtimin e saj. Ky dokumentacion vërteton destinacionin e mjediseve në katin e gjashtë të godinës, duke specifikuar nëse ato janë të destinuara për zyra apo për mjedise të tjera ndihmëse.

Mungon informacioni lidhur me trajtimin e kërkesës time për t’u vendosur në një zyrë tjetër për shkak të problemeve shëndetësore dhe arsyet pse kjo kërkesë nuk është marrë parasysh. Nga informacionet dhe deklaratat e znj.B. , kuptohet qartë që ajo nuk tregon aspak kujdes jo vetëm për shëndetin tim, por edhe për jetën time. Gjuha e përdorur nga ajo është e papërshtatshme, aq më pak për një drejtues me mandat të caktuar në kryer të një institucioni të pavarur.

Lidhur me situatën time shëndetësore, ka dështuar të paraqesë prova të vërtetuara se ndaj meje nuk ka ndodhur diskriminim. Problemet e mia shëndetësore, të trajtuara në vitet 2017, 2021, dhe 2024, janë nga ato situata e cila nuk lidhet me raportin mjeko ligjor që ndodhet në dosjen personale të çdo zyrtari, por me paaftësinë e përkohshme në punë për shkak të diagnozës përcaktuar sipas raportit mjekësor.

Me kthimin në punë më është përsëritur situata shëndetësore, të cilat kanë filluar për herë të parë në periudhën janar -2017-shkurt 2017, më është përsëritur në periudhat shtator-tetor-nëntor 2021 dhe në periudhën korrik-gusht-shtator 2024, e cila është lehtësisht e verifikueshme nga raportet mjekësore të paraqitura pranë ILDKPKI, të cilat nuk janë paraqitur në dojen time personale nga ILDKPKI dhe në vërtetimin e pagesës për këto periudha.

Po kështu në vitin 2024 pavarësisht dijenisë për problemet e mia shëndetësore, sipas raporteve shëndetësore paraqitur pranë ILDKPKI, para se të funksiononte sistemi elektronik, jam vendosur në një ambjent pune i cili ndikoi keq në shëndetin tim dhe njoftimi verbal dhe jo në formë shkresore ndodhi për shkak të prezumimit se situata shëndetësore ishte e ditur dhe nuk mendova se procedurat formale ishin më të rëndësishme se shëndeti im dhe do të përdreshin si mjet për t’u mbrojtur, sikurse po përdoret nga znj.B. për të justifikuar veprimet disriminuese kryer ndaj meje, në mënyrë përsëritëse.

Rezulton se znj.B. edhe pse ka bërë verifikime pranë Qendrës Shëndetësore (mjekut të familjes dhe Komisionit Mjekësor) lidhur me situatën time shëndetësore, kartelën dhe raportet mjekësore për më

shumë se një herë, hesht për një fakt të tillë, pa sqaruar se veprimet e kryera nuk janë shkak i diskriminimit dhe se veprime të tilla janë kryer prej saj dhe ILDKPKI edhe për rastet e paaftësisë së përkohshme në punë të zyrtarëve të tjerë.

Lidhur me procedurën për njoftimin e znj.B. , si drejtuese e ILDKPKI dhe eprore e drejtëpërdrejtë, për mësimdhënien pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023-2024, gjatë periudhës që kam qenë në listë pritje dhe pa asnjë të ardhur për jetesë, për shkak të veprimeve diskriminuese të znj.B. . Ndryshe nga sa parashtron znj.B. në lidhje me procedurën e ndjekur për trajtimin e kërkesës time nr.2641 prot., datë 14.06.2024, për marrje leje lidhur me mësimdhënien pranë Shkollës së Magjistraturës, në përgjigjen kthyer prej saj me shkresën nr.2641/1 prot., datë 20.06.2024, referuar nenit 10, të VKM nr. 874, datë 29.09.2021, ka kërkuar prej meje të vendos në dispozicion orarin e plotë (ditë/muaj/vit, orë) gjatë të cilës parashikohej angazhimi pranë Shkollës së Magjistraturës, duke mos sjellë në vëmendje të Komisionerit, faktin se me shkresën datë 21.06.2024, kam vënë dijeni për sa kërkohej prej saj.

Nuk jam njoftuar nga znj.B. dhe ILDKPKI, se ka filluar procesin e verifikimit për kërkesën e paraqitur prej meje. Në përgjigjen e saj ishte e qartë se kërkohej programi për tu vënë në dispozicion për sa kërkohej leje prej meje.

Lidhur me sa pretendohet në materialin paraqitur prej saj, trajtimi i kërkesës për lejimin tim për të ushtruar një veprimtari të lejueshme nga ligji, në shkelle të parimit kushtetues të hierarkisë të ligjeve, sjell në vëmendje të Komisionerit se është një situatë e përsëritur në rastin e kandidimit për Gjykatën Kushtetuese, në rastin e transferimit pranë KJV dhe ndalimin për tu kthyer në vendin e punës pas mbarimit të detyrës së caktuar për shkak të funksionit nga Inspektori i Përgjithshëm, si dhe në rastin e fillimit të procedurës së verifikimit për një veprimtari të lejueshme, duke zbatuar VKM nr.874, datë 29.09.2021. Edhe në rastin e ushtrimit të mësimdhënies, ILDKPKI duhet të paraqesë nëse ka kryer veprime verifikuese sikundër ka vepruar në rastin tim ndaj punonjësve të ILDKPKI, por edhe në rastet e subjekteve deklarues nëse ka një qasje të tillë.

Veprimet e kryera pa më njoftuar dhe sjellja diskriminuese nëpërmjet mesazheve në celular, dërguar nga Drejtoresha e Personelit, vërtetojnë se ka dështuar të provojë ligjshmërinë e procedurës verifikuese të nisur, si dhe përsa parashtron se jam angazhuar në veprimtari të jashtme ende pa përfunduar procedura e verifikimit nga eprori direkt.

Është në të drejtën e znj.B. për të patur edhe në këtë rast qasjen e saj, në mënyrën se si do të zbatojë ligjin, por në funksion të sjelljes diskriminuese ndaj meje në mënyrë të përsëritur më ka vendosur dukshëm në një situatë diskriminuese dhe pavarësisht se ka kryer verifikime pranë Shkollës së Magjistraturës, unë akoma nuk kam një përgjigje, lidhur me lejen për të vazhduar mësimdhënien, duke cenuar në shkelle të ligjit, të drejtën ligjore që gëzoj për të ushtruar veprimtari të cilat lejohen nga ligji, në përmbushje të detyrimit ligjor për të plotësuar orët në rast se do të shkëputem për këtë qëllim, jashtë orarit zyrtar.

6. Me shkresën nr. 1165/5 prot., datë 19.11.2024, Komisioneri kërkoi nga ILDKPKI informacionin dhe dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Kopje të kërkesë padisë të paraqitur nga ankuesja dhe që është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lidhur me pretendimin për rikthimin në punë, pas përfundimit të veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJV). (*Referuar informacionit të përcjellë nga ana e ILDKPKI nëpërmjet shkresës nr. 2851/1 prot., datë 12.09.2024*)
- Kopje të praktikës/dokumentacionit për regjistrimin e ankueses si nëpunës civil në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- Informacion në lidhje me numrin e inspektorëve të ILDKPKI që kanë qenë anëtarë në KJV, në momentin e përfundimit të veprimtarisë së këtij komisioni? Sa prej tyre pas përfundimit të veprimtarisë së KJV janë rikthyer në detyrë dhe sa nuk janë rikthyer? Cilat janë arsyet e pamundësisë për rikthimin në detyrë, për ata inspektorë të cilët nuk janë rikthyer?
- Informacion në lidhje me procedurat e ndjekura për rikthimin në punë të inspektorëve të tjerë të ILDKPKI, pas përfundimit të veprimtarisë së KJV, shoqëruar me kopje të praktikave/dokumentacionit përkatës për secilin inspektor?

ILDKPKI ktheu përgjigje në lidhje me sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr.2851/3 prot., datë 21.11.2024, duke informuar Komisionerin si më poshtë:

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar dhe përfundimit të veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJV), nëpunësi i vetëm që është kthyer në detyrë dhe aktualisht vazhdon marrëdhëniet e punësimit është znj.Dh.S . Nëpunësit e tjerë, për shkaqe ligjore të pavarura nga ky hetim administrativ, dhe/ose personale nuk kanë vijuar marrëdhëniet e punësimit pranë Inspektoriatit të Lartë.

7. Nëpërmjet *emailit* të datës 09.12.2024, ankuesja ka depozituar prapësime dhe akte shtesë në lidhje me shkresën nr. 1165/5 prot., datë 19.11.2024, të ILDKPKI, ku ndër të tjera parashtron se:

Në kundërshtim me ato që shprehen në shkresën nr. 2851/3 prot., datë 21.11.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm, rezulton se unë jam e vetmja inspektore e ILDKPKI që jam ndaluar dhe nuk jam kthyer në vendin e punës pranë ILDKPKI më 04.01.2023, pas përfundimit të detyrës të caktuar si anëtare zëvendësuese në KJV, nga Inspektori i Përgjithshëm, për shkak të funksionit tim si Inspektore e ILDKPKI.

Caktimi im si anëtare zëvendësuese pranë KJV në muajin gusht 2021 ishte pasojë e veprimeve hakmarrëse dhe diskriminuese ndaj meje, për shkak të ankimit tim si kandidate për anëtare në

Gjykatën Kushtetuese, lidhur me veprimet e paligjshme të zyrtarëve të ILDKPKI gjatë procesit të kontrollit të interesave private për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe jo për shkak të krijimit të një vakance pranë KJV. Kjo është evidentuar nga fakti që anëtarja e dorëhequr e KJV u kthye sërish pranë ILDKPKI, dhe për rrjedhojë, në këto kushte nuk ka patur një vakancë pranë KJV.

Pavarësisht shkresës nr. 1971/1, datë 30.04.2018 të ILDKPKI (e cila u shfuqizua në vitin 2019, pasi u zëvendësua me një shkresë tjetër), për caktimin tim si anëtare zëvendësuese pranë KJV, nuk jam caktuar si anëtare zëvendësuese për asnjë vakancë të krijuar pranë KJV gjatë vitit 2019 dhe vitit 2020, për shkak të mungesës së dakordësisë sime, ndryshe nga inspektorët e tjerë që kanë shprehur pëlqimin e tyre. Ky është rasti i inspektorëve që janë caktuar si anëtarë zëvendësues, përfshirë inspektoren e dorëhequr që u kthye pranë ILDKPKI, pa përfunduar veprimtaria e KJV.

Po ashtu, gjatë vitit 2021 janë krijuar dy vakanca pranë KJV për shkak të daljes në pension të inspektorëve të KJV. Vakanca e parë ka ardhur nga pensionimi i inspektore/anetare të KJV, E. D, në muajin shkurt 2021, dhe vakanca e dytë nga pensionimi i inspektore/anetare të KJV, K.N, në muajin korrik 2021. Inspektori i Përgjithshëm në detyrë ka bërë caktimet e zëvendësimit, përkatësisht me inspektoren Z.Gj dhe inspektorin N.K, përmes shkresave nr. 1431 prot., datë 22.02.2022 dhe nr. 3086 prot., datë 05.07.2021, pavarësisht nga shkresa nr. 1971/1, datë 30.04.2018, e cila ishte shfuqizuar, duke u pretenduar se nëpërmjet kësaj shkrese, unë jam caktuar anëtare zëvendësuese.

Nga ana tjetër, kthimi im në vendin e punës si inspektore pranë ILDKPKI më datë 13.06.2024 është realizuar nga ILDKPKI në një vend pune të krijuar pas daljes në pension të ish-anetarit të KJV, N. K, i cili është kthyer në vendin e punës si inspektor pranë ILDKPKI pas përfundimit të veprimtarisë së KJV. Pra, rezulton se të gjithë inspektorët e ILDKPKI, të caktuar si anëtarë pranë KJV, janë kthyer në vendet e tyre të punës pranë ILDKPKI pas përfundimit të veprimtarisë së KJV.

Po ashtu, është e provuar se, jo vetëm caktimi im si anëtare zëvendësuese pranë KJV në gusht 2021 ka qenë pasoje e veprimeve hakmarrëse dhe diskriminuese ndaj meje, duke kthyer pranë ILDKPKI anëtarin e KJV të dorëhequr pa përfunduar veprimtaria e KJV, por gjithashtu, pas përfundimit të veprimtarisë së KJV në janar 2023, më është ndaluar kthimi në vendin e punës pranë ILDKPKI, duke përjetuar një diskriminim të dytë dhe duke u bërë subjekt i riviktimizimit. Zyrtarë të caktuar pranë ILDKPKI, me veprimet ose mosveprimet e tyre, kanë pasur qëllim largimin tim nga puna, duke marrë pjesë në procedurat për caktimin tim pranë KJV dhe ndalimin e kthimit në vendin e punës, duke më diskriminuar dhe ridiskriminuar në krahasim me zyrtarët e tjerë, inspektorët anëtarë të KJV, në shkelje të ligjit dhe statusit të punonjësit civil, si dhe të të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe konventore.

Përmes shkresës nr.6901/1 prot, datë 06.01.2023, bashkëngjitur me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm, vërtetohet se ILDKPKI, pavarësisht njoftimit për kthimin tim në vendin e punës më 1 janar 2023, dhe të inspektorëve/anëtarë të KJV, ka kërkuar pranë Departamentit të Administratës

Publike (DAP), me shkresën nr. 3759 prot., datë 22.12.2022, listën e vendeve vakante të nivelit të lartë drejtues në shërbimin civil në administratën shtetërore, bashkëngjitur me shkresën nr. 259/3 datë 26.01.2023. Ky informacion, i marrë nga DAP dhe i dërguar nëpërmjet postës nga ILDKPKI, nuk ka asnjë lidhje me detyrimin e ILDKPKI për të më kthyer në vendin e punës pas përfundimit të veprimtarisë së KJV, as me marrëdhënien e punësimit tim si zyrtare e nivelit të lartë pranë një institucioni të pavarur publik, siç është ILDKPKI, krahasuar me vendet e punës të zyrtarëve të administratës shtetërore, të administruar nga DAP. Ky moment i shkeljes së ligjit nga ILDKPKI është trajtuar në kërkesën për padi që kam paraqitur në gjykatë.

Në veprimet e ILDKPKI, është evidentuar qartazi aplikimi i një standarti të dyfishtë në lidhje me pezullimin e statusit të punonjësit civil për inspektorët e caktuar anëtarë të KJV. Pavarësisht pezullimit të statusit të nëpunësit civil, anëtarët e KJV nga radhët e inspektorëve të ILDKPKI janë trajtuar si nëpunës civilë, pasi sipas statusit të nëpunësit civil, janë bërë zëvendësime për ta pranë KJV, duke plotësuar moshën për pension pleqërie. Inspektori i Përgjithshëm, sipas dosjes së personelit të administruar nga ILDKPKI, bazuar në kudo ligjor të nëpunësit civil (ligji 152/2013) ka kryer zëvendësimin e inspektorëve pranë KJV, duke caktuar anëtarë zëvendësues nga radhët e inspektorëve të ILDKPKI, kur mosha e përcaktuar në kriterin e zgjedhjes si anëtar i KJV ishte 65 vjeç. Kështu, rezulton se në shkurt 2021 ka dalë në pension pleqërie inspektorja E. D, në korrik 2021 ka dalë në pension pleqërie inspektorja K.N, dhe në qershor 2022 ka dalë në pension pleqërie inspektorja V. K.

Në rastin tim, pavarësisht se pezullimi i statusit nuk është marrë në funksion të procesit të caktimit si anëtare e KJV dhe nuk është njoftuar KJV, me mbarimin e veprimtarisë së KJV, ky pezullim është përdorur si mjet për të cenuar marrëdhënien time të punësimit pranë ILDKPKI dhe për të më diskriminuar. Përtej kësaj qasjeje me standart të dyfishtë, e cila ka pasoja në marrëdhënien e punësimit ndaj meje si inspektore e ILDKPKI, nëpërmjet vendimit nr. 566, date 13.03.2023, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, ka vendosur se inspektorët e ILDKPKI, kanë statusin e nëpunësit civil edhe gjatë kohës që kryejnë detyrën e anëtarit të KJV, si inspektorë të ILDKPKI. Pra, deri më 31.12.2022, kam pasur statusin e nëpunësit civil, duke qenë inspektore e ILDKPKI si dhe gjatë kohës që kam kryer detyrën e anetares së KJV. Në vazhdim, trajtimi im, sipas shkresës nr. 259/3 prot., datë 26.01.2023, paraqet një ridiskriminim ndaj meje dhe një riviktimizim në lidhje me marrëdhënien e punësimit si inspektore e ILDKPKI, krahasuar me të gjithë inspektorët e ILDKPKI, të cilët janë kthyer në vendet e tyre të punës që kishin para emërimit si anëtarë të KJV.

Inspektorja që krijoi vakancën pranë KJV në gusht të 2021 është kthyer pranë ILDKPKI dhe inspektori që doli në pension pleqërie në qershor 2024 është kthyer në vendin e punës pranë ILDKPKI në janar 2023. Pra, unë jam i vetmi inspektor që jam larguar nga ILDKPKI në gusht 2021 pa pasur asnjë shkak ligjor dhe i vetmi inspektor që më është ndaluar kthimi në ILDKPKI me mbarimin e veprimtarisë së KJV.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Faktet dhe rrethanat.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja znj. Dh.S , është nëpunëse civile dhe është në marrëdhënie pune pranë ILDKPKI, në pozicionin e punës Inspektor. Marrëdhëniet e punës midis ankuses dhe ILDKPKI kanë filluar në bazë të vendimit “Për emërim në detyrë”, të datës 03.05.2004.

Rezulton se, ankuesja ka përfunduar studimet e larta në vitin 1987, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Dega Drejtësi dhe për periudhën 2005-2007 ka kryer studime pasuniversitare në Fakultetin e Drejtësisë, Departamenti i të Drejtës Publike, Universiteti i Tiranës, duke u pajisur me diplomën me gradë “Master në Shkencat Publike”.

Rezulton se, në datën 10.12.2020 ankuesja ka shprehur interesin dhe ka marrë pjesë në procesin e zhvilluar nga Kuvendi i Shqipërisë për përzgjedhjen e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI. Në këtë proces, së bashku me ankuesen ka marrë pjesë edhe znj.E.B , e cila aktualisht ushtron funksionin e Inspektorese të Përgjithshme të ILDKPKI, pozicion në të cilin është emëruar në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 21 shkurt 2021.

Ankuesja ka kandiduar për vendet vakante për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 16.01.2017, 22.11.2018, 19.04.2019 dhe 03.06.2021.

Në kuadër të procesit të zhvilluar, rezulton se me shkresën nr.3221 prot., datë 02.08.2021 me lëndë “Kthim pa veprim i Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private e Kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, të ILDKPKI, deklarata e pasurisë dhe interesave e bërë nga ankuesja si kandidate për Gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, nuk është pranuar dhe i është kthyer asaj pa veprim, duke u konsideruar si e padorëzuar pranë ILDKPKI .

Në kuadër të procedurës së kandidimit për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, me vendimin nr.4, datë 31.08.2021 “Për ndalimin e kandidimit të zonjës Dh.S në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 16.01.2017, 19.04.2019 dhe 03.06.2021” dhe vendimin nr.5, datë 31.08.2021 “Për ndalimin e kandidimit të zonjës Dh.S në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, 19.04.2019 dhe 03.06.2021”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), ka vendosur ndalimin e kandidimit të ankuses për pozicionet vakante për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Ankuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, duke paditur njëkohësisht KED dhe ILDKPKI. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin nr.65, datë 29.09.2021, duke vendosur rrëzimin e padisë së palës paditëse Dh.S , në lidhje me

kërkimet ndaj KED, si dhe pushimin e padisë për kërkimet ndaj ILDKPKI (ankuesja gjatë gjyqimit ka kërkuar pavlefshmërinë e shkresës nr.3221 prot., datë 02.08.2021, të ILDKPKI).

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, ankuesja ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.00-2022-684 (nr.31003-00064-2022 i Regjistrimit Themeltar), datë 17.03.2022, ka disponuar me vendim për mospranimin e rekursit të paraqitur nga ankuesja, nëpërmjet të cilit ankuesja ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pranimin e padisë.

Në vijim, rezulton se ankuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e vendimit nr.65, datë 29.09.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata Kushtetuese ka vendosur përfundimisht me vendimin nr.23, datë 10.10.2022, rrëzimin e kërkesës së ankueses.

Me shkresën nr. 1957/1 prot., datë 30.04.2018, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI dhe bazuar në ligjin nr.12/2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, ankuesja është caktuar si anëtare zëvendësuese në KJV. Ankuesja nuk e ka ushtruar funksionin si anëtare e KJV deri në momentin kur, me shkresën nr. 3234/1 prot datë 16.08.2021, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, ka njoftuar KJV se ankuesja do të zëvendësojë një prej anëtarëve, përfaqësuese e ILDKPKI, të dorëhequr nga KJV.

Rezulton se me shkresën nr.1852 prot datë 05.08.2021, Kryetari i KJV, i ka kërkuar ILDKPKI zëvendësimin e anëtares së KJV të dorëhequr, dorëheqje e cila është miratuar nga KJV me vendimin nr.5, datë 05.08.2021. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr.3234/1 prot datë 16.08.2021, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, ka njoftuar se anëtari që do të zëvendësojë anëtares e dorëhequr do të jetë ankuesja znj. Dh.S , e cila është caktuar paraprakisht si anëtare zëvendësuese me shkresën nr.1957/1 prot., datë 30.04.2018, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI dhe ka kaluar fazën e kontrollit dhe përzgjedhjes nga Bordi i Përzgjedhjes së anëtarëve të KJV në Ministrinë e Brendshme.

Në vijim, me urdhrin nr.8, datë 26.08.2021, të Kryetarit të KJV, *“Për fillimin e marrëdhënieve financiare për znj.Dh. S. pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit”*, është vendosur fillimi i marrëdhënieve financiare të ankueses pranë KJV në datë 03.09.2021. Ky urdher i është përcjellë ILDKPKI me shkresën nr.199/1 prot., datë 26.08.2021, të Kryetarit të KJV.

Me vendimin nr.18, datë 30.08.2021 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI *“Për pezullimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të znj.Dh.S për shkak të ligjit për periudhën përkatëse të emërimit”*, ankuesja me detyrë Inspektor në ILDKPKI është pezulluar nga shërbimi civil dhe

kohëzgjatja e pezullimit do të jetë për periudhën përkatëse të emërimit në detyrë si Anëtar i KJV. Marrëdhëniet financiare ndërpriten në datën 03.09.2021.

Ankuesja nuk ka qenë dakort me caktimin si anëtare në KJV dhe pezullimin nga shërbimi civil dhe i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke paditur njëkohësisht ILDKPKI e KJV dhe duke kërkuar, shfuqizimin e vendimit nr.18, datë 30.08.2021 të ILDKPKI, për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil, shfuqizimin e aktit 3234/1 prot, datë 16.08.2021 të ILDKPKI për caktimin e ankuses si anëtare të KJV, shfuqizimin e urdhrit nr.08, datë 26.08.2021 të KJV për fillimin e marrëdhënies financiare për ankuesen pranë KJV, konstatimin e paligjshmërisë së shkresës nr.1957/1 prot datë 30.04.2018 të ILDKPKI, për caktimin e ankuses si anëtare zëvendësuese për KJV, detyrimin e ILDKPKI për rikthimin e ankuses në pozicionin Inspektor në ILDKPKI. Me vendimin nr.363, datë 03.02.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjatë shqyrtimit nuk u administrua informacioni nëse ky vendim ka marrë formë të prerë.

Me vendimin nr.32, datë 13.10.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI “Për marrjen e masave administrative për mosdorëzim në afat të deklaratës së interesave privatë”, ndaj ankuses është marrë masa administrative gjobë në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë për mosdorëzim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme të deklaratës së interesave privatë, pas largimit nga funksioni si Inspektore në ILDKPKI. Ankuesja e ka kundërshtuar vendimin me gjobë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, e cila me vendimin nr.2142 datë 20.07.2022, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr.32, datë 13.10.2021. Gjatë shqyrtimit nuk u administrua informacioni nëse ky vendim ka marrë formë të prerë.

Në datën 17.11.2022, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.78/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në datë 28.12.2022. Në nenin 52, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “Veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit përfundon brenda datës 31 dhjetor 2022”, ndërsa në nenin 29, pika 3, përcaktohet: “Në përfundim të procesit të vlerësimit, anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit kthehen në vendet e tyre të punës ose me pëlqimin e tyre, në vende të barazvlefshme”.

Nëpërmjet një shkrese me lëndë “Njoftim”, që mban datën 30.11.2022, ankuesja së bashku me inspektorët N.K dhe L.Q, i janë drejtuar ILDKPKI, ku ndër të tjera shprehen se: “Duke qenë se veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit përfundon brenda datës 31 Dhjetor 2022, në zbatim të dispozitave ligjore sa më sipër, kthehemi për vijimin e funksionit të inspektorit pranë institucionit të ILDKPKI-së në datën 1 janar 2023.”

Me shkresën nr.3759 prot datë 22.12.2022, me lëndë “Kërkesë mbi vendet e lira në TND”, ILDKPKI i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike (DAP) me një kërkesë për vendosjen në

dispozicion të listës së vendeve vakante në shërbimin civil për nivelin e lartë drejtues, me qëllim ofrimin e vendeve të barazvlefshme për nëpunësit e nivelit të lartë drejtues të shërbimit civil të ILDKPKI, në përfundim të veprimtarisë së KJV dhe funksionit si anëtarë të KJV. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr.690/1 prot., datë 06.01.2023 me lëndë “Mbi emërimin në një pozicion të nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore, pjesë e shërbimit civil” (administruar pranë ILDKPKI me nr.3759/1 prot., datë 11.01.2023), DAP ka sqaruar mënyrën e plotësimit të vendeve vakante të nivelit të lartë drejtues pjesë e shërbimit civil, si dhe ka vendosur në dispozicion listën e vendeve vakante të nivelit të lartë drejtues në aparatet e ministrive të linjës.

Me shkresën nr.147 prot., datë 29.12.2022 (administruar pranë ILDKPKI me nr.40 prot datë 05.01.2023), me lëndë “Njoftim për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 78/2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar” KJV, ndër të tjera parashtrohet: “Inspektori i Përgjithshëm në zbatim të ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, ka caktuar anëtarë pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit në periudha të ndryshme kohore nga viti 2019 deri në vitin 2021, Inspektorët e ILDKPKI-së, L.Q, Dh.S , N.K, A.L.....Meqënëse Ligji nr.78/2022, ka hyrë në fuqi më datën 28.12.2022, për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion nga hyrja në fuqi ligjit dhe përfundimit të aktivitetit institucional, ju njoftojmë përfundimin e marrëdhënieve të punës më datën 31.12.2022, të anëtarëve të KJV-së nga radhët e inspektorëve të ILDKPKI-së, caktuar nga Inspektori i Përgjithshëm.”

Me shkresën nr.259 prot., datë 12.01.2023 me lëndë “Mbi vijueshmërinë e marrëdhënies në shërbimin civil”, ILDKPKI i ka kërkuar ankueses që të shprehet me shkrim lidhur me vijueshmërinë e marrëdhënies në shërbimin civil.

Me shkresën nr.259/1 prot datë 16.01.2023, drejtuar Drejtoreshës pranë Drejtorisë së Financës dhe Administrimit në ILDKPKI dhe shkresës nr. 259/2 prot datë 16.01.2023, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të ILDKPKI dhe për dijeni Inspektorese të Përgjithshme të ILDKPKI, ankuesja ka konfirmuar vijueshmërinë e marrëdhënieve të punës në funksionin e inspektorit pranë ILDKPKI-së që prej datës 01.01.2023.

Në vijim, me shkresën nr.259/3 prot, datë 26.01.2023, ILDKPKI ka informuar ankuesen se: “Nga të dhënat e administruara rezulton se, në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu IX, neni 53 “Pezullimi nga shërbimi civil” dhe neni 54 “Pezullimi për shkak të ligjit”, si dhe Vendimit nr.124, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, i ndryshuar, jeni pezulluar nga shërbimi civil, nga pozicioni “Inspektor” pranë ILDKPKI, për shkak të emërimit në detyrën Anëtar i Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Në kushtet kur, veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit ka përfunduar brenda datës 31 dhjetor 2022, Inspektoriati i Lartë, bazuar në nenin 56 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në gërmën “c”, të pikës 17, të Kreut II, të Vendimit nr.124, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar, ju njofton se, në pamundësi të rikthimit në pozicionin e mëparshëm të punës për arsye se ky pozicion është plotësuar përfundimisht, apo transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, ka vendosur regjistrimin tuaj si nëpunës civil në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.”. Nëpërmjet kësaj shkrese ankueses i është vendosur në dispozicion lista e dërguar nga DAP, mbi vendet vakante të nivelit të lartë drejtues në aparatet e ministrive të linjës me qëllim ndjekjen e procedurave të parashikuara nga pika 5/1 e nenit 30, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar³. Nga aktet e administruara rezulton se, ankuesja e ka kundërshtuar në gjykatë shkresën nr.259/3 prot., datë 26.01.2023 si një akt të paligjshëm dhe ka kërkuar rikthimin e saj në pozicionin inspektor pranë ILDKPKI-së.

Në datën 19.04.2023, ankuesja ka paraqitur një ankesë pranë Kuvendit me objekt: “Ankim ndaj veprimeve në kundërshtim me ligjin, kryer gjatë ushtrimit të funksionit publik nga znj.E.B , Inspektore e Përgjithshme e ILDKPKI”. Kjo ankesë, nëpërmjet shkresës nr.1354/1 prot., datë 19.04.2023, i është përcjellë ILDKPKI, duke kërkuar sqarime për problemet që ngrihen në ankesë. ILDKPKI i ka kthyer përgjigje Kuvendit të Shqipërisë me shkresën nr.1880/1 prot., datë 03.05.2024. Shkresa kthim përgjigje drejtuar Kuvendit, është nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i ILDKPKI.

Me shkresën nr.1354/3 prot., datë 04.10.2023, Kuvendi, i kthen përgjigje ankueses se : “Në përgjigje të kërkesës së Kuvendit, ky institucion sqaron se: “Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në ushtrimin e kompetencave, në cilësinë e titullarit të institucionit dhe njëkohësisht të organit vendimarrës, nuk gjendet në kushtet e kryerjes së veprimeve në kundërshtim me ligjin, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duke qenë se veprimtaria rezulton në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi”, duke i vendsur në dispozicion ankueses kopjen e përgjigjes së ILDKPKI.

Me shkresën nr. 2547 prot., datë 03.06.2024, me lëndë “Njoftim”, ILDKPKI informon ankuesen se: “Në Administratën e Inspektoriatit të Lartë është krijuar 1 (një) vend i lirë pune, nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues, në pozicionin e punës “Inspektor”, kategoria e pagës II-1. Në kuadër të parashikimeve të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, për shkak të listimit tuaj si nëpunës civil në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56 të ligjit të sipërcituar (listë pritje), ILDKPKI ju ofron mundësinë e sistemimit tuaj në këtë pozicion të rregullt të shërbimit civil. Sa më sipër kërkohet

³ Neni 30, pika 5/1, e ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar: “5/1. Departamenti i Administratës Publike, me kërkesë të nëpunësit të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e pavarura dhe pas marrjes së pëlqimit të njesisë përgjegjëse në këto institucione, mund ta emërojë këtë nëpunës në një pozicion TND-je në institucionin e administratës shtetërore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të ndjekë programin e formimit të thelluar të kandidatëve për anëtarë të trupës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues në ASPA.”

pëlqimi juaj për vijimin e mëtejshëm të procedurave për emërimin tuaj në pozicionin e punës “Inspektor” pranë ILDKPKI.” Në vijim me shkresën e administruar pranë ILDKPKI me nr.2547/1 prot, datë 10.06.2024, ankuesja ka kthyer përgjigje, duke parashtruar se: “Duke qenë se, kthimi në detyrë si “Inspektor” është edhe një nga kërkimet e mia në proceset gjyqësore ndaj jush, mund të paraqitem për të ushtruar detyrën në momentin që do më njoftoni paraprakisht për datën e caktuar nga fillon edhe përfitimi i të drejtave të mia financiare....”

Me shkresën nr.2547/2 prot, datë 10.06.2024, me lëndë “Njoftim”, ILDKPKI ka njoftuar ankuesen se duhet të paraqitet në ambientet e Inspektoriatit të Lartë, ditën e enjte, datë 13.06.2024. Në vijim të këtij njoftimi, me vendimin nr.5, datë 10.06.2024 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI “Për rikthimin në detyrë të znj.Dh.S dhe fillimin e marrëdhënieve financiare”, është vendosur: “1. Rikthimi i nëpunësit civil znj.Dh.S në pozicionin e punës Inspektor në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. 2. Marrëdhëniet financiare fillojnë më datë 13.06.2024,.....”

Sa më sipër rezulton se, ankuesja është rikthyer në pozicionin e punës Inspektor në ILDKPKI, në datën 13.06.2024.

Pas rikthimit pozicionin e punës Inspektor në ILDKPKI, rezulton se, ankuesja është vendosur në një ambient pune, i cili është mbajtur më parë nga nëpunësi me funksion “Inspektor” vakanca e të cilit u plotësua me kthimin e ankuses, por i ndryshëm nga zyra ku ajo ka punuar para se të caktohej anëtare në KJV. Në zyrën në të cilën është sistemuar ankuesja pas rikthimit të saj në detyrë, janë të vendosur dhe dy inspektorë të tjerë. Zyra ndodhet në katin e gjashtë, në një godinë, ku deri në katin e 5-të është në dispozicion ashensori.

Ankuesja pretendon se, ambienti i punës ku është sistemuar pas rikthimit të saj në detyrë në datën 13.06.2024, është një ambient i papërshtatshëm, pasi ndodhet në një ambjent të madh në katin e gjashtë të ndërtesës, i cili për shkak të konstruksionit të ndërtesës duke qenë taraca e objektit ka temperatura të larta në verë dhe të ulta në dimër, dhe aksesimi i tualetit ndodhet një kat më poshtë, pa ashensor, kushte të cilat i kanë dëmtuar shëndetin. Ankuesja pretendon se, shqetësimin në lidhje me ambientin e punës në raport me gjendjen e saj shëndetësore ia ka bërë të ditur në mënyrë verbale Sekretarit të Përgjithshëm, pa deklaruar momentin se kur i ka paraqitur këto kërkesa verbale, por ka marrë po verbalisht një përgjigje se, nuk ka zyra dhe këto janë kushtet.

Gjatë shqyrtimit të ankesës ILDKPKI prapësoi se, ankuesja nuk ka paraqitur asnjë kërkesë mbi kushtet e punës, duke theksuar se, nga data 13.06.2024 kur ankuesja është rikthyer në detyrë, është paraqitur në punë vetëm 8 ditë punë dhe për periudhën tjetër të muajit qershor e në vijim është trajtuar me raport mjekësor.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, ankuesja është trajtuar me raport mjekësor pasi ka qenë në kushtet e paaftësisë për punë për periudhat 24.06.2024 deri në 29.06.2024, 02.07.2024-16.07.2024, 16-07.2024 - 15.08.2024 dhe 15-08.2024 – 14.09.2024.

Referuar raporteve mjekësore, diagnoza e përcaktuar nga mjeku për të gjitha rastet dhe raportet e lëshuara për ankuesen është: “M51.1 – Çrregullime të tjera lumbare të disqeve me radikulopati.”

Një ditë pas rikthimit në detyrë të ankueses, kjo e fundit ka paraqitur kërkesën me nr.2641 prot., datë 14.06.2024, drejtuar Inspektore së Përgjithshme dhe Sekretarit të Përgjithshëm në ILDKPKI, nëpërmjet të cilës kërkon leje për ushtrimin e mësimdhënies pranë Shkollës së Magjistraturës. Në kërkesën e saj ankuesja parashtron se, për vitin akademik 2023-2024 është angazhuar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe duke marrë parasysh se mësimi zhvillohet gjatë orarit të punës, kërkon leje nga puna gjatë orëve që janë caktuar nga Shkolla e Magjistraturës. Angazhimi sipas programit të miratuar për trajnimin vazhdues lidhur me vitin akademik 2023-2024, do të jetë në datë 21.06.2024.

Me shkresën nr.2641/1 prot., datë 20.06.2024, ILDKPKI, i kthen përgjigje ankueses në lidhje me këtë kërkesë, duke parashtruar: “Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike” dhe në përmbushje të kërkesave të nenit 10, vendosni në dispozicion orarin e plotë (ditë/muaj/vit, orë) gjatë të cilit parashikohet angazhimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në parashtrimet e palëve rezulton se ankuesja ka zhvilluar mësimdhënien pranë Shkollës së Magjistraturës në datën 21.06.2024, por sipas saj gjatë zhvillimit të trajnimit ajo është kontaktuar nga punonjës të ILDKPKI, të cilët i kanë kërkuar arsyen e mosparaqitjes në punë.

Pas datës 21.06.2024 (ditë e premte), ankuesja nuk është paraqitur më në punë dhe nga data 24.06.2024 e në vijim është trajtuar me raport mjekësor.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi me nr. 165, datë 13.08.2024, duke pretenduar se është diskriminuar në të drejtën për punësim nga ana e punëdhënësit ILDKPKI dhe titullarit të këti institucioni, znj.E.B , Inspektore e Përgjithshme e ILDKPKI.

Vlerësimi i Komisionerit

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivist të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Sipas nenit 3 dhe 3/1, të LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma. Pavarësisht nga forma e shfaqjes së tij, në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i

shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim/trajtime më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim/trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtime i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim përbën diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Parimi i mosdiskriminimit ndalon situatat ku personat ose grupet e personave të cilët janë në një situatë të njëjtë ose të ngjashme trajtohen ndryshe/në mënyrë më pak të favorshme dhe ku personat ose grupet e personave të cilët janë në situata të ndryshme trajtohen në mënyrë të njëjtë, duke u vendosur rrjedhimisht në kushte më pak të favorshme. Pra, në kuptim të LMD, diskriminimi karakterizohet në çdo rast nga një ndryshim në trajtim/trajtime më pak i favorshëm në situata të krahasueshme. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet përmes krahasimit ndërmjet personit që pretendon se është diskriminuar, i cili posedon shkakun e mbrojtur dhe një personi tjetër, pra krahasuesit, i cili nuk e posedon shkakun e mbrojtur (pra shkakun e pretenduar të diskriminimit).

Nga shqyrtimi i parashtrimeve dhe pretendimeve të palës ankuese, prapësimeve të subjekteve kundër të cilit është paraqitur ankesa, si dhe akteve të administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, konstatohet sa më poshtë:

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh”, të LMD, ku përcaktohet: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:.....dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese.”, momentet e poshtëshënuara të pretenduara si diskriminuese nga ankuesja, nuk mund të pranohen për shqyrtim nga Komisioneri, pasi janë paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga dispozita e mësipërme.

Në lidhje me pretendimin për mosekzekutimin e vendimit nr.2504, datë 27.06.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton nga aktet e administruara se me anë të këtij vendimi është vendosur: “Pranimi i kërkesë padisë. Detyrimin e palës së paditur ILDKPKI ti paguajë paditëses Dh.S shtesën për kualifikimin post master nga data e ndërprerjes së pagesës shtator 2011 referuar VKM nr.545/2011, ndryshuar me VKM nr.52/2012 dhe nga data 01.03.2017 referuar VKM nr.187/2017”. Duke mos qenë dakort me mënyrën e ekzekutimit të këtij vendimi nga ana e ILDKPKI, për ekzekutimin e tij ankuesja i është drejtuar shërbimit përmbarimor gjyqësor privat. Me shkresën nr.978/2 prot, datë 18.01.2021, Zyra e Përmbarimit Privat “Albase” sh.p.k me përmbaruesin gjyqësor privat B. N ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. ILDKPKI, ka kundërshtuar gjyqësisht veprimet e përmbaruesit privat dhe nga aktet rezulton se, me vendimin nr.900, datë 31.03.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur: “Pranimi i kërkesë padisë së paditësit ILDKPKI. Shfuqizimi i veprimit përmbarimor nr.978/2 prot, datë 18.01.2021 protokolluar pranë paditësit më datë 20.01.2021, për fillimin e ekzekutimit të

detyrueshëm të vendimit nr.2504, datë 27.06.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.” Gjykata ka konstatuar se ILDKPKI, ka ekzekutuar vullnetarisht detyrimin e saj dhe nuk ishte nevoja për të kaluar në ekzekutim të detyruar nga përmbaruesi gjyqësor. Në kushtet kur ankesa është depozituar në datën 13.08.2024, Komisioneri vlerëson se, pretendimi në lidhje me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor, është paraqitur jashtë afateve ligjore të parashikuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të LMD dhe Komisioneri nuk mund ta marrë atë në shqyrtim.

Në lidhje me çështjen e kandidimit të ankueses në Gjykatën Kushtetuese, ankuesja pretendon se është diskriminuar në procesin e konkurimit si pasojë e shkresës nr.3221 prot., datë 02.08.2021, të Inspektorit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Nëpërmjet kësaj shkresë, ILDKPKI i ka kthyer pa veprim deklaratën ankueses, sikur të mos ishte paraqitur dhe kjo ka ndikuar në procedurën e konkurimit përpara KED.

Në lidhje me procedurën e kandidimit organi që ka marrë vendimin që ankuesja të mos vijojë procedurën është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED). Ky institucion, në përfundim të procedurës administrative, ka marrë vendimin nr.4, datë 31.08.2021 “*Për ndalimin e kandidimit të zonjës Dh.S në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 16.01.2017, 19.04.2019 dhe 03.06.2021*”, si dhe vendimin nr.5, datë 31.08.2021 “*Për ndalimin e kandidimit të zonjës Dh.S në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, 19.04.2019 dhe 03.06.2021*”. Ankuesja i ka kundërshtuar gjyqësisht këto vendime, duke iu drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe duke paditur njëkohësisht KED dhe ILDKPKI. Në përfundim të këtyre proceseve gjyqësore ka rezultuar se vendimmarrjet e KED në lidhje me ndalimin e kandidimit të ankueses në Gjykatën Kushtetuese, kanë qenë të drejta dhe të bazuara.

Përpara Komisionerit ankuesja pretendon se është diskriminuar gjatë procesit të kandidimit të saj në Gjykatën Kushtetuese si pasojë e shkresës nr.3221 prot., datë 02.08.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Në kushtet kur sjellja e pretenduar si diskriminuese mban datën 02.08.2021 dhe provohet se ankuesja ka marrë dijeni për shkresën nr. 3221 prot datë 02.08.2021 të ILDKPKI në datën 03.08.2021 dhe ankesa është paraqitur në datën 13.08.2024, Komisioneri vlerëson se ky pretendim është jashtë afateve ligjore, më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit dhe më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese, të parashikuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të LMD dhe Komisioneri nuk mund ta marrë atë në shqyrtim.

Në lidhje me pretendimet e ankueses sa i përket raporteve mjekësore gjatë periudhave të pretenduara përgjatë vitit 2021, pretendimet në lidhje me cenimin në kryerjen e lejes vjetore të vitit 2020 dhe 2021, pretendimet për kthimin e dosjes së personelit gjatë periudhës nëntor 2021, edhe këto pretendime rezultojnë jashtë afatit ligjor më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese, të përcaktuar nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të LMD, dhe rrjedhimisht Komisioneri nuk mund ti marrë ato në shqyrtim. Referuar kërkesave dhe ankesave që ankuesja ka paraqitur kundrejt ILDKPKI dhe korrespondencës që ka mbajtur me këtë të fundit, rezulton se ajo ka patur dijeni në lidhje me këto sjellje të pretenduara si diskriminuese, në kohën e ndodhjes së tyre, ndërsa ankesa është paraqitur në datën 13.08.2024.

Në lidhje me pretendimet e ankueses për caktimin e saj si anëtare në KJV (shkresa nr.3234/1 prot datë 16.08.2021 e ILDKPKI) dhe pezullimin nga shërbimi civil për shkak të ligjit për periudhën e emërimit si anëtare në KJV (vendimi nr.18, datë 30.08.2021 i ILDKPKI), rezulton se pasi ka marrë dijeni dhe duke mos qenë dakort me këto akte, ankuesja i ka bërë këto pretendime objekt të shqyrtimit gjyqësor duke paraqitur në datën 07.10.2021 kërkesë padi kundër ILDKPKI dhe KJV (kundër KJV padia është në lidhje me nxjerrjen e urdhrit për fillimin e marrëdhënieve financiare pranë KJV për ankuesen), pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata, me vendimin nr.263, datë 03.02.2022, ka vendosur të rrëzojë padinë e ankueses si të pabazuar në ligj dhe në prova. Në kushtet kur ankesa është paraqitur në datën 13.08.2024 dhe ankuesja ka patur dijeni të paktën brenda datës 07.10.2024, datë në të cilën ka paraqitur padinë para gjykatës, pretendimet për diskriminim të paraqitura para Komisionerit, janë jashtë afateve të përcaktuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të LMD, pasi janë paraqitur më vonë se dy vjet nga marrja dijeni.

Në lidhje me pretendimin për gjobitjen e ankueses në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë për shkak të mosdeklarimit në përfundim të funksionit si inspektore e ILDKPKI, me vendimin nr.32, datë 13.10.2021 të ILDKPKI, nga aktet e administruara konstatohet se, ankueses i është komunikuar ky akt në datën 13.10.2021 dhe në datën 29.10.2021, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është regjistruar kërkesë padia e ankueses, për kundërshtimin e këtij akti. Me vendimin nr.2142, datë 20.07.2022, kjo gjykatë ka vendosur pranimin e padisë së ankueses dhe shfuqizimin e vendimit me gjobë ndaj ankueses. Faktet e mësipërme tregojnë se ankuesja ka patur dijeni për veprimin e pretenduar diskriminues që prej datës 13.10.2021, ndërsa paraqitja e pretendimit për diskriminim pranë Komisionerit është bërë në datën 13.08.2024, pra në tejkalim të afatit ligjor jo më vonë se 2 vjet nga marrja dijeni, të përcaktuar në nenin 33, pika 4, germa “dh”, të LMD.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak se, pas përfundimit të funksionit si anëtare e KJV më datë 31.12.2022, nuk është rikthyer në pozicionin e saj të punës si inspektore në ILDKPKI, rikthim i cili duhet të kishte ndodhur në datën 04.01.2023, por nëpërmjet shkresës nr. 259/3 prot, datë 26.01.2023 ajo është nxjerrë në mënyrë të padrejtë në listë pritje.

Ankuesja gjithashtu pretendon se pas rikthimit në pozicionin e punës Inspektore në ILDKPKI në datën 13.06.2024, ajo vazhdon të diskriminohet:

- pasi është vendosur në një ambient pune të papërshtatshëm dhe si pasojë është vendosur në kushte të disfavorshme për shkak të gjendjes së saj shëndetësore;
- në të drejtën për të ushtruar veprimtari të lejueshme, siç është mësimdhënia pranë Shkollës së Magjistraturës në datën 21.06.2024;
- në lidhje me trajtimin dhe pagesën e raporteve mjekësore të lëshuara për periudhën 06.07.2024 deri në 15.08.2024 dhe periudhën 15.08.2024 - 14.09.2024.

Komisioneri vlerëson se, të gjitha pretendimet e mësipërme, janë brenda afateve ligjore të përcaktuara nga neni 33, pika 4, germa “dh”, të LMD dhe ato janë marrë në shqyrtimin dhe do të trajtohen nga ana e Komisionerit si më poshtë:

Në lidhje me mosrikthimin e ankueses në pozicionin e punës Inspektor në ILDKPKI, pas përfundimit të funksionit Anëtar në KJV dhe nxjerrja e saj në listë pritje.

Nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se, me shkresën nr.147 prot datë 29.12.2022, të KJV, (kjo shkresë është administruar pranë ILDKPKI me nr.40 prot datë 05.01.2023), ILDKPKI është njoftuar se, në datën 31.12.2022 anëtarëve të KJV nga radhët e inspektorëve të ILDKPKI caktuar nga Inspektori i Përgjithshëm, ju përfundojnë marrëdhëniet e punës me KJV, si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr.78/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

Dita e parë e punës për vitin 2023, i korrespondon data 04 janar 2023, datë në të cilën ankuesja pretendon se duhet të ishte rikthyer në pozicionin e punës si inspektore në ILDKPKI, pas përfundimit të funksionit si anëtare në KJV.

Me shkresën nr.259 prot., datë 12.01.2023, me lëndë “Mbi vijueshmërinë e marrëdhënies në shërbimin civil”, ILDKPKI i ka kërkuar ankueses që të shprehet me shkrim lidhur me vijueshmërinë e marrëdhënies në shërbimin civil. Me shkresën nr.259/1 prot, datë 16.01.2023, dhe nr. 259/2 prot., datë 16.01.2023, ankuesja ka konfirmuar vijueshmërinë e marrëdhënies të punës në funksionin e inspektorit pranë ILDKPKI-së. Në vijim, me shkresën nr.259/3 prot., datë 26.01.2023, të Sekretarit të Përgjithshëm të ILDKPKI me lëndë “Kthim përgjigje”, ankueses i është bërë me dije se në pamundësi të rikthimit të saj në pozicionin e mëparshëm të punës për arsye se ky pozicion ishte plotësuar përfundimisht, apo transferimit në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, ishte vendosur regjistrimi i saj si nëpunëse civile në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Ankuesja pretendon se mos rikthimi i saj në pozicionin e mëparshëm të punës inspektore në ILDKPKI dhe nxjerra në listë pritje janë veprime të padrejta dhe në kundërshtim me ligjin, ndërsa ILDKPKI, prapësoi duke parashtruar se, ka trajtuar marrëdhënien e punës dhe statusin e nëpunësit civil për ankuesen, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Për më tepër, znj.S. , me qëllim dhënien e mundësisë për të qenë përsëri pjesë e nivelit të lartë të shërbimit civil, i është vendosur në dispozicion lista e dërguar nga DAP për vendet vakante në administratën publike, për të shprehur pëlqimin e mundshëm për pozicionet e propozuara, duke patur në këtë mënyrë mundësi për të ndjekur procedurën për të siguruar pagën e saj.

Me vendimin nr.18, datë 30.08.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI “Për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil të znj.Dh.S për shkak të ligjit për periudhën përkatëse të emërimit”, ankuesja me detyrën Inspektor në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, është pezulluar nga shërbimi civil. Sipas vendimit, pezullimi nga shërbimi civil për ankuesen do të jetë për periudhën përkatëse të emërimit në detyrën si anëtare e KJV. Ky vendim, pavarësisht se është kundërshtuar nga ankuesja në gjykatë si një akt i paligjshëm, nuk rezulton që të jetë shfuqizuar nga gjykata (vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka rrëzuar padinë e ankueses). Rezulton se shkak i pezullimit të ankueses nga shërbimi civil ka pushuar së

ekzistuari në momentin që ankuesja ka përfunduar detyrën si anëtarë e KJV, data 31.12.2022. Ligjërish pas kësaj date shkak për të cilin ankuesja është pezulluar nuk ka ekzistuar më. Nga aktet e administruara rezulton se, pezullimi i ankueses ka zgjatur nga data 30.08.2021 (data e vendimit të pezullimit) deri në datën 31.12.2022, pra rreth 16 muaj.

Instituti i pezullimit, rregullohet nga ligji nr.152/2013 “Për shërbimin civil”, i ndryshuar, në Kreun IX “Pezullimi nga Shërbimi Civil”, nenet 53-56. Efektet e pezullimit, rregullohen nga neni 56, i këtij ligji ku përcaktohet:

“1. Në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së shërbimit civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ose në rast se pozicioni i mëparshëm është i plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori. Në rast se kjo është e pamundur, nëpunësit regjistrohen në një listë, e cila administrohet nga njësia përgjegjëse. Ata qëndrojnë në këtë listë deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil.

1/1. Njësia përgjegjëse është e detyruar që në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, t’ia ofrojë fillimisht këtyre nëpunësve civilë, që plotësojnë kriteret përkatëse, duke respektuar në çdo rast shkaqet e përmendura nga neni 48, pika 3, e këtij ligji, i cili në këtë rast zbatohet me ndryshimet përkatëse.

1/2. Këta nëpunës civilë mund të emërohen përkohësisht me pëlqimin e tyre edhe për plotësimin e vendeve të lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme. Njësia përgjegjëse në këtë rast bën emërimin e përkohshëm të këtyre nëpunësve.

2. Në rastin e pezullimit për një afat deri në 3 muaj, pozicioni i mëparshëm i punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit.

3. Periudha e pezullimit, në rastet e parashikuara nga shkronja “c”, e nenit 53, nga shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, të pikës 1, të nenit 54 dhe nga shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 55 të këtij ligji, llogaritet si vjetërsi në shërbimin civil.

4. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë. Në rastet e parashikuara në nenin 53, shkronja “c”, dhe në nenin 54, shkronja “dh”, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, përveç shtesës për kushte pune. Në rastet e parashikuara në nenin 54, pika 1, shkronjat “c” dhe “e”, nëpunësi përfiton pagën e plotë, përveç shtesës për kushte pune.

5. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni.”

Në bazë nenit 56, pika 2, të Ligjit “Për nëpunësin civil”, detyrimi për të mbajtur të paplotësuar vendin e nëpunësit civil që është pezulluar, është vetëm kur periudha e pezullimit zgjat deri në 3 muaj. Në rastin e ankueses pezullimi ka zgjatur rreth 16 muaj.

Të marra së bashku pikat 1 e 2, të nenit 56, tregojnë se nëpunësi civil i pezulluar ruan vendin e tij të punës vetëm kur periudha e pezullimit zgjat deri në tre muaj dhe në rast të kohëzgjatjes së pezullimit

për më shumë se tre muaj, nëpunësi nuk e ka të garantuar vendin e mëparshëm të punës, pasi institucioni ka të drejtën që të plotësojë atë. Në kushtet kur rikthimi i nëpunësit civil në vendin e mëparshëm të punës nuk është i mundur, ai regjistrohet në listë pritje.

Referuar shkresës nr.259/3 prot., datë 26.01.2023, ILDKPKI ka njoftuar ankuesen se ka vendosur regjistrimin e saj si nëpunës civil në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pra, në bazë të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili normon marrëdhënien e punësimit midis ankueses e cila ka statusin e nëpunësit civil dhe ILDKPKI, nëpunësi civil, pas përfundimit të pezullimit mund të nxirret në listë pritje në rast të pamundësisë për ta sistemuar atë në vendin e mëparshëm të punës.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak se, pas përfundimit të funksionit si anëtare e KJV, nuk është rikthyer në pozicionin e saj të punës si inspektore në ILDKPKI, duke qene e vetmja inspektore, pasi të gjithë inspektorët e tjerë të cilët kanë qenë anëtarë pranë KJV janë rikthyer në pozicionet e tyre të punës si inspektorë pranë ILDKPKI, menjëherë pasi kanë përfunduar detyrën si anëtarë të KJV, ndërsa ajo është nxjerrë në mënyrë të padrejtë në listë pritje.

Sipas shkresës nr. 147 prot., datë 29.12.2022, të KJV, konstatohet se, në momentin e përfundimit të veprimtarisë së këtij komisioni, anëtarët e KJV, të caktuar nga radhët e inspektorëve të ILDKPKI, të cilëve ju përfundonte marrëdhënia e punësimit me KJV, për shkak të përfundimit të veprimtarisë së këtij komisioni, kanë qenë ankuesja dhe tre inspektorë të tjerë L.Q, N.K dhe A.L.

Krahasuesit e pretenduar nga ankuesja, duke ju referuar inspektorëve që kanë qenë anëtarë në KJV në periudhat e mëparshme, të cilët janë rikthyer në detyrë në një moment të ndryshëm nga momenti i përfundimit të veprimtarisë së KJV, datë 31.12.2022, nuk ndodhen në njëjtat kushte me ankuesen. Komisioneri vlerëson se, në të njëjtat kushte me ankuesen kanë qenë vetëm inspektorët të cilët kanë qenë anëtarë të KJV deri në datën e përfundimit të veprimtarisë së këtij Komisioni, datë 31.12.2022, konkretisht inspektorët L.Q, N.K dhe A.L.

Referuar shkresës nr.2851/3 prot., datë 21.11.2024, ILDKPKI informoi Komisionerin se, me përfundimin e veprimtarisë së KJV, nëpunësi i vetëm që është rikthyer në detyrë dhe aktualisht vazhdon marrëdhëniet e punësimit është ankuesja. Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga ILDKPKI, nëpunësit e tjerë, për shkaqe ligjore të pavarura nga ky hetim administrativ dhe/ose shkaqe personale nuk kanë vijuar marrëdhëniet e punësimit pranë ILDKPKI.

Nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës dhe konkretisht shkresës nr. 15732/1 prot., datë 1.8.2024, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, shkresë e cila u vendos në dispozicion nga ankuesja, rezulton se, pranë ILDKPKI për periudhën janar 2023, figuron i punësuar inspektori N.K, i cili sikundër ankuesja ka qenë anëtar në KJV, në momentin e përfundimit të veprimtarisë së këtij komisioni.

Bazuar në të dhënat e mësipërme rezulton se, nga 4 inspektorë, duke përfshirë edhe ankuesen, të cilët kanë qenë anëtarë në KJV në momentin e përfundimit të veprimtarisë së këtij komisioni (datë 31.12.2022), në janar të vitit 2023 rezulton të jetë kthyer në detyrën e mëparshme inspektor në ILDKPKI, vetëm inspektori N.K.

Referuar pretendimeve të ankueses, N.K rezulton të jetë inspektori, i cili ka dalë në pension duke krijuar një vend vakant në ILDKPKI, vakancë e cila është plotësuar nga ILDKPKI nëpërmjet emërimit dhe rikthimit në pozicionin e inspektores, ankuesen Dh.S , në datën 13.6.2024.

Ankuesja nuk pretendon se, në janar të vitit 2023 apo edhe për periudhën në vijim, deri në momentin e rikthimit të saj në detyrë, datë 13.6.2024, të ketë patur vende të lira për pozicionin e punës inspektor ose pozicione të barazvlefshme pune, në të cilat ajo mund të ishte emëruar nga ILDKPKI, pas përfundimit të funksionit si anëtare e KJV, përveç vakancës në të cilën është emëruar inspektori N.K, i cili rezulton në të njëjtat kushte me ankuesen. Ankuesja pretendon se ILDKPKI ka patur detyrimin për ta rikthyer atë në detyrë në 4.01.2023, pas përfundimit në datë 31.12.2022, të funksionit të saj anëtare në KJV.

Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 3, pika 3, përcakton se: “3. *“Diskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.”*

Sipas nenit 11, të këtij Kodi, dispozitë e cila sanksionon parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, sanksionohet se: *“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme: a) është i parashikuar me ligj; b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit; c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi;dhe; ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.”*

Komisioneri konstaton se, ILDKPKI, në përfundim të veprimtarisë së KJV, ka rikthyer në detyrë, në janar të vitit 2023 inspektorin N.K në vakancën që ka rezultuar në ato momente. Ndërsa sikurse më sipër është arsyetuar, ILDKPKI, në cilësinë e punëdhënësit dhe bazuar në ligjin nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, nuk ka patur detyrimin për të mbajtur të lirë pozicionin e ankueses, në kushtet kur pezullimi nga shërbimi civil ka vazhduar për një periudhë më të gjatë se 3 muaj. Në këtë mënyrë, ILDKPKI, në cilësinë e punëdhënësit ka ushtruar pushtetin e tij diskrecionar duke rikthyer në detyrë njërin prej inspektorëve, të cilëve iu kishte mbaruar marrëdhënia e punësimit me KJV, si pasojë e përfundimit të veprimtarisë së këtij komisioni në 31.12.2022. Referuar fakteve, rrethanave dhe provave të administruara, Komisioneri nuk konstaton se ILDKPKI ka ushtruar në mënyrë të paligjshme diskrecionin në cilësinë e punëdhënësit, duke rikthyer në detyrë inspektorin N.K, i cili ndodhet në të njëjtat kushte me ankuesen dhe jo këtë të fundit.

Pavarësisht se ankuesja është trajtuar ndryshe duke mos u rikthyer në detyrë pas përfundimit të funksionit si anëtare në KJV krahasimisht me inspektorin N.K, ky trajtim i diferencuar, pra mosrikthimi në detyrë i ankueses, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, për sa kohë që ILDKPKI, nuk rezulton të ketë ushtruar në mënyrë të paligjshme diskrecionin në cilësinë e punëdhënësit, për të rikthyer në detyrë vetëm një prej inspektorëve sipas vakancës që ka rezultuar në ato momente. Në kushtet kur inspektori N.K ndodhet në kushte të njëjta me ankuesen dhe plotëson kriteret për tu rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës si inspektor pranë ILDKPKI, fakt ky që nuk kundërshtohet nga ankuesja, Komisioneri nuk mund të vlerësojë apo të gjykojë diskrecionin e ushtruar nga ana e punëdhënësit/ ILDKPKI, duke vendosur të rikthejë inspektorin N.K dhe jo ankuesen.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se sjellja e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa nuk vjen në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar dhe ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues në lidhje me mos rikthimin e saj në pozicionin e punës Inspektor në ILDKPKI, në përfundim të funksionit si Anëtare në KJV.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për vendosjen në kushte të papërshtatshme pune, pas rikthimit të saj në pozicionin e punës Inspektore, në ILDKPKI.

Rezulton se ankuesja është rikthyer në detyrën si Inspektore në ILDKPKI në datën 13.06.2024. Ankuesja pretendon se, pas rikthimit të saj në detyrë është vendosur në kushte të papërshtatshme pune për shkak të gjendjes së saj shëndetësore. Referuar raporteve mjekësore, diagoza e përcaktuar nga mjeku për paaftësinë në punë të ankueses është “*Çrregullime të tjera lumbare të disqeve me radikulopati*”.

Gjatë shqyrtimit nuk rezultoi e provuar që ankuesja të ketë paraqitur verbalisht ose me shkrim ndonjë kërkesë në lidhje me papërshtatshëmrinë e kushteve të punës si pasojë e gjendjes së saj shëndetësore.

Komisioneri e vlerëson të pabazuar pretendimin e ankueses se punëdhënësi ka patur dijeni në lidhje me papërshtatshmërinë e vendit të punës për shkak të gjendjes së saj shëndetësore nga raportet mjekësore, për të cilat provohet se punëdhënësi ka patur dijeni pasi ato administrohen *online* nëpërmjet Portalit e-*Albania*. Raportet mjekësore tregojnë dhe provojnë paaftësinë e përkohshme në punë të ankueses për periudhat respektive për të cilat janë lëshuar këto raporte nga ana e mjekut, por nuk tregojnë apo provojnë asgjë në lidhje me papërshtatshmërinë e vendit të punës në të cilin është sistemuar ankuesja pas rikthimit të saj në detyrë në datën 13.06.2024.

Gjendja shëndetësore e ankueses, e provuar nëpërmjet raporteve mjekësore mund të shërbejë si një shkak që ankuesja ti kërkonte punëdhënësit përshtatjen e vendit të punës për shkak të gjendjes shëndetësore në të cilën gjendej. Vetëm mbi bazën e një kërkesë nga ana e punëmarrësit, pra ankueses në këtë rast, punëdhënësi/ILDKPKI ka detyrimin që të vlerësojë përshtatshmërinë e vendit të punës së ankueses në raport me gjendjes e saj shëndetësore.

Në lidhje me ambientin e punës në të cilin ankuesja është sistemuar pas rikthimit të saj në detyrë pranë ILDKPKI rezultoi e provuar se, ankuesja është vendosur në një ambient pune ku së bashku me të punojnë edhe dy inspektorë të tjerë, si dhe ndihmës inspektori që punon së bashku me ankuesen. Gjithashtu konstatohet se, aksesimi i ambientit të punës nuk paraqet vështirësi të tepruara, pasi pavarësisht se gjendet në katin e gjashtë të godinës, ashensori i vendosur në këtë godinë është funksional deri në katin e pestë, duke bërë që të gjithë punonjësit e akomoduar në katin e gjashtë, përfshi ankuesen, duhet të ngjisin nëpërmjet shkallëve vetëm një kat.

Referuar raporteve mjekesore rezulton se, ankuesja ka qenë në kushtet e paaftësisë për punë për periudhat 24.06.2024 deri më 29.06.2024, 02.07.2024 deri më 16.07.2024, 16-07.2024 deri më 15.08.2024 dhe 15-08.2024 deri më 14.09.2024.

Pra, nga momenti i rikthimit në punë në datën 13.06.2024, ankuesja ka punuar deri në datën 21.06.2024. Më pas ajo nuk është paraqitur në punë, por është trajtuar me raport mjekësor në kushtet e paaftësisë së përkohshme në punë.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja nuk i është nënshtuar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën në lidhje me ambient e punës ku është sistemuar pas rikthimit në detyrë në datën 13.06.2024.

Në lidhje me mësimdhënien pranë Shkollës së Magjistraturës në datën 21.06.2024.

Një ditë pas rikthimit në detyrë ankuesja ka paraqitur kërkesën me nr.2641 prot., datë 14.06.2024, drejtuar znj.E.B , Inspektore e Përgjithshme dhe z.A.B, Sekretar i Përgjithshëm në ILDKPKI, nëpërmjet të cilës kërkon leje për ushtrimin e mësimdhënies pranë Shkollës së Magjistraturës, më datë 21.06.2024.

Me shkresën nr.2641/1 prot, datë 20.06.2024, ILDKPKI, i kthen përgjigje ankueses në lidhje me këtë kërkesë, duke kërkuar nga ankuesja që të vendoste në dispozicion orarin e plotë (ditë/muaj/vit, orë) gjatë të cilit parashikohet angazhimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

Rezulton se ankuesja e ka zhvilluar mësimdhënien pranë Shkollës së Magjistraturës në datën 21.06.2024, por sipas saj gjatë zhvillimit të trajnimit ajo është kontaktuar nga punonjës të ILDKPKI, të cilët i kanë kërkuar arsyen se pse nuk është paraqitur në punë.

Ankuesja pretendon se, veprimet e kryera dhe sjellja diskriminuese nëpërmjet mesazheve në celular nga drejtoresha e personelit, vërtetojnë se ILDKPKI ka dështuar të provojë ligjshmërinë e procedurës verifikuese të nisur dhe e kanë ekspozuar atë ndaj një trajtimi diskriminues.

Në lidhje me pretendimet për angazhim pranë Shkollës së Magjistraturës, ILDKPKI gjatë shqyrtimit të ankesës prapësoi duke parashtruar se, procedura e ndjekur për trajtimin e kërkesës për të kryer veprimtari të jashtme, është plotësisht në përputhje me parashikimet e VKM nr.874, datë 29.9.2021 *“Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të*

administratës publike”, dhe ankuesja, ndryshe nga sa ajo pretendon, është angazhuar në veprimtari të jashtme ende pa përfunduar procedura e verifikimit nga eprori direkt.

Komisioneri konstaton se, rregullat e klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe procedura që ndiqet për ushtrimin e veprimtarive të jashtme të lejueshme për nëpunësit e institucioneve të administratës publike, përcaktohen në VKM nr. 874, datë 29.9.2021 “*Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike*”. Konkretisht në nenin 10, të kësaj VKM-je përcaktohet si vijon:

“1. Veprimtaritë e jashtme të nëpunësit të institucioneve të administratës publike janë të lejueshme vetëm kur nuk bëhen pengesë për përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive zyrtare.

5. Nëpunësi i administratës publike njofton zyrtarisht eprorin direkt dhe njësinë e burimeve njerëzore të institucionit për veprimtarinë e jashtme që do të kryejë, duke bërë një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë, të objektivave dhe qëllimeve të organizatës, për të cilën kryen veprimtarinë e jashtme.

6. Mbështetur në të dhënat e marra, eprori direkt, në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, verifikon nëse veprimtaria që do të kryejë nëpunësi kategorizohet si e lejueshme sipas këtij vendimi. Eprori direkt merr vendimin për përcaktimin e veprimtarisë së jashtme si të lejueshme apo jo dhe ia komunikon atë, me shkrim, nëpunësit kërkuar.

7. Ndaj vendimit të eprorit direkt mund të bëhet ankim pranë titullarit të institucionit, i cili merr vendim të arsyetuar.

8. Në rastet kur nëpunësi i institucioneve të administratës publike, me miratimin e titullarit/eprorit, kryen veprimtari mësimdhënieje apo trajnuese gjatë orarit zyrtar, ai është i detyruar të kompensojë orët e punës brenda javës, pas orarit zyrtar të punës.

9. Kur nëpunësi kryen veprimtari të jashtme përpara fillimit të marrëdhënieve të punës, në çastin e punësimit ai njofton me shkrim eprorin direkt dhe njësinë e burimeve njerëzore dhe merr miratimin e tyre sipas përcaktimeve në këtë kre, për të vijuar me ushtrimin e veprimtarisë së jashtme.”

Përcaktimet e mësipërme tregojnë se, nëpunësi mund të kryejë veprimtari të jashtme të lejueshme me miratimin me shkrim të eprorit direkt dhe se eprori direkt në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, ka të drejtë të verifikojë nëse veprimtaria që do të kryejë nëpunësi kategorizohet si e lejueshme sipas këtij vendimi.

Sa më sipër, shkresa nr.2641/1 prot, datë 20.06.2024, nëpërmjet të cilës ILDKPKI, kërkon nga ankuesja që të vendosë në dispozicion informacione të mëtejshme në lidhje me këtë angazhim të saj pranë Shkollës së Magjistraturës, nuk vjen në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së sipërcituar.

Gjithashtu, rezulton se ankuesja e ka zhvilluar veprimtarinë e mësimdhënies për të cilën ka paraqitur kërkesën dhe nuk rezulton që ajo të ketë pasur ndonjë pasojë negative nga ana e punëdhënësit.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja nuk i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën në lidhje me ushtrimin e mësimdhënies pranë Shkollës së Magjistraturës në datën 21.06.2024.

Në lidhje me pagesën e dy raporteve mjekësore të lëshuara për ankuesen, njëri për periudhën 16.07.2024 - 15.08.2024 dhe raporti tjetër për periudhën 15.08.2024 - 14.09.2024, Komisioneri vlerëson se, këto janë pretendime të reja që nuk lidhen me objektin fillestar të ankuesës së regjistruar pranë Komisionerit, me datë 13.08.2024. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, të gjitha pretendimet që nuk janë objekt i ankuesës fillestare, nuk janë objekt i analizës së këtij vendimi dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohen gjykimit të tij. Këto pretendime, nëse çmohen nga ana e saj, ankuesja ka të drejtën dhe mund t'i paraqesë pranë Komisionerit brenda afateve ligjore, nëpërmjet paraqitjes së një ankese të re.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja znj. Dh.S nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë, nga ana e ILDKPKI dhe znj.E.B , Inspektore e Përgjithshme e ILDKPKI. Në mungesë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses znj. Dh.S , për shkaqet e pretenduara prej saj, nga ana e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe znj. E.B , Inspektore e Përgjithshme, Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendje shëndetësore, çdo shkak tjetër

Fusha: Punësim

Lloji i vendimit: Mosdiskriminim